

INSTITUTI I FOLKLORIT

---

398

Rust

**RAPSODË POPULLORE  
SOKOL ARIFI**

TIRANË, 1966

398  
R22

INSTITUTI I FOLKLORIT

RAPSODË POPULLORË  
SOKOL ARIFI

LIBRIKA E SHTËPISË  
GJENITORËVË

38380  
39216

TIRANË 1966

Redaktorë:

Zihni Sako, Qemal Haxhihasani, Arsen Mustaqi

Tirazhi: 2000 kopje formati: 78x100/32 Stash: 2204-65

Shtypur në N.I.S.H. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tiranë



**SOKOL ARIFI**

## SOKOL ARIFI

*Sokol Arifi lindi në vitin 1927, në katundin Marrkaj të rrethit të Tropojës. Megjithëse në moshë të re është mjaft i formuar si këngëtar popullor. Ai është rritur në ambientin epik të folklorit tradicional të krahinave të Veriut, në fryshtë e të bëmeve të kreshnikëve të Jutbinës dhe të heroizmave, që treguan të parët tonë në luftrat për mbrojtjen e vendit dhe çlirimin kombëtar. Sokoli di me mijra vargje prej këtyre këngëve, të cilat i pat përvehtësuar që në fëmini, si në familje dhe në rrethin e tij shoqëror. Babai i Sokolit ka qënë i njohur në krahinën e Krasniques si mjeshtër në të rënët e fyellit. Disa melodi të tij kanë qënë inçizuar në pllaka gramafoni para çlirimit. Jeta baritore e moshiës së rinisë la mbresa të thella në shpirtin e rapsodit. Gjatë kësaj kohe, ai pati rast të ushqehet me bukuritë magjepse të Alpeve tona të Veriut dhe të Valbonës së kristaltë, të jetojë zakonët tradicionale të krahinës së vet. Në kushtet e prapambetjes së vëndit, nuk mundi të marrë kurrëfarë arsimi. Shkrim e këndim ka mësuar vetëm pas çlirimit, në kurset kundër analafabetizmit. Më 1945 hyri në radhët e Rinisë komuniste, ka marrë pjesë n'aksionet e ndryshme të rinisë: në rrugën «Kukës-Peshkopi» në hidrocentralin «Karl Marks» mbi lumin e Matit, etj. I pajisur me veta të veçanta që dallojnë zakonisht rapsodët tanë: kujtesë të fortë, talent poetik, inteligjencë, ai nisi të merrej me thurrjen e vargjeve dhe ngritjen e këngëve të reja.*

*Ai e fitoi pjekurinë si këngëtor popullor rreth viti 1954. Objekt i fryshtëzimeve dhe i krijimeve të tij poetike bëhen veprat e mëdha të ndërmarrura nga pushteti popullor, sidomos ndërtimet dhe transformimet e kra-*

hinës së tij, Malësisë së Gjakovës — ngritja e qytetit të ri Bajram Curri, kthimi i Cërnicës në një zonë bujqësore të lulëzuar, punimet në Begaj për kanalet vadi-tëse të Krasniqes, zhvillimi kultural i këtyre krahinave, hapja e gjimnazit në qëndrën e rrethit, e shkollave 8 vjeçare që mbushin Malësinë, etj. Duke u nisur nga këto tema lokale, Sokol Arifi ka kaluar edhe në tema me karakter më të përgjithshëm, si në këngët për Republikën, për shokun Enver Hoxha, Hidrocentralin K. Marks, 13 vjetorin e çlirimt, 50 vjetorin e pavareësisë. Në strukturën e këtyre këngëve ruhen në përgjithësi skemat dhe elementet poetike të folklorit tradicional: shtjellimi epik i ngjarjeve, pasurimi i tyre me apostrofa, similituda, kahasime, hiperbolizime epike, etj. Megjithkëtë aty s'mungojnë edhe ndikimet e kohës. Krahas këngëve me gjërsinë e zakonëshme të folklorit epik të kaluar, gjenden edhe këngë me një numur të kufizuar vargjesh. Ritmi dinamik i jetës së sotëme ka filluar të ndikojë drejt një farë konçiziteti në folklorin e Veriut.

Te poezitë e Sokol Arifit ndihet patriotizmi i mësive tonë punonjëse, entuziazmi i njerëzve të thjeshtë për ecjen përpëra dhe lulëzimin e vendit: Ja pra shokë Malsia ime... (me këtë termë kuptoherë Malsia e Gjakovës, vendlindja e rapsodit), Diell' i bukur i ra Malësisë!... C'ka Malsia tuj gjimue? Ato na japid një kuadër tipik të një krahine malore, që ndërtion socializmin në një skaj kufitar të atdheut: Na fshatarët e Malësisë, / si jetojmë n'shkrepë t'Shqipnisë, / karshi shtetit të Jugosllavisë, / kur vje' pika e mjesdits, / gja nuk niejmë, veç krizma minsh; kërcet mina, bahet jezer, / e çajnë shkamin meniherë!... Një vrull i tillë pune ndërtimitare ulon në të gjithë frontet e jetës së kësaj krahine; dikur të braktisur e të prapambetur: në frontin e kollektivizmit dhe të modernizimit bujqësor, si kuptoherë nga këngët nr. 21 e 23 të kooperativave fshatare, që ngrihen në këtë rreth, këngët nr. 19 e 20 të krizmës së traktorëve, që ushtojnë ditë e natë «n'Shelzen t'Gashit, deri n'Razë t'Grisë», në frontin e ndërtimeve, të zhvilli-

*mit kultural, shëndetësor etj. si tregojnë këngët nr. 8,9,18, ku «tingujt e lahitës» këndoijnë për dritën elektriqe, që ndriçon «fundin e bjeshkëve», qytetin e por-salindur të Bajram Currit; për gjimnazin, pallatin e kulturës, shkollat, spitalet etj., që janë ngritur sot në Malësi.*

*Një vend të veçantë zë në këto tematika e vendos-mërisë, guximit dhe vigjilencës, që tregojnë masat tonë popullore në mbrojtjen e atdheut socialist përpëra diversioneve të armikut. Ky motiv shprehet nëpërmjet ngjarjeve konkrete të jetuara nga banorët e kësaj krahine — me vdekjen heroike të 5 ushtarëve, që bëhen kallkan maje bjeshkës së Dobërdolit, duke vigjeluuar lëvizjet e diversantëve titistë, me shëmbullin e lartë të vetmohimit të oficerit prej Dragobie Ram Sadrise, i cili u hidhet mu në grykë tradhëtarëve, që lëshohen në tokën shqiptare nga revizionistët jugosllavë.*

*Patriotizmi i masave tona pasqyrohet në mënyrë origjinale me këngën e bukur «Në qoshe të Pukës n'atë Qerret», ku flitet për lojën e guximëshme të ushtarakëve rezervistë në Veri, me betimin solemn, që bën luftëtarin buzë kufirit: Pasha dy dritat e synit, / pasha iden e famshme të Leninit!... S'shkel ktu kurr kamba e an-mikit! / pa shkue gjaki deri n'buzë t'Drinit, / për pa u la me gjak Valbona, / s'shkel anmiki malet tona.*

*Sokol Arifi, me gjithë thjeshtësinë e tij, ka një botë të gjërë dhe komplekse. Atë e frymëzojnë mbrëmjet e ngrohta të vitit të ri, që organizohen për të vegjëlit, festivalet folkloristike, ku manifestohen traditat e shkëll-qyera të krahinës së tij, dimëri i jashtëzakonëshëm që pllakosi këto anë më 1954-1955 dhe ndihma e papritur që i erdhi popullit nga pushteti nëpër vijën ajrorë, tregimet historike të luftrave që janë bërë në këtë krahinë kundër pushtuesve turq, heroizmi i malësorëve të udhë-hequr nga Mic Sokoli në kohën e Lidhjes së Prizrenit, vrasja e Maxhar Pashës më 1878, figura burrërore e Bajram Currit etj.*

*Sadoqë s'ka pasë fatin të ndjekë mësimet shkolllore, Sokoli tregon një ngritje dhe pjekuri të veçantë, duke*

bërë objekt të poezive të tij edhe tema të jetës së gjërë botërore. Kështu ai ka kënduar për Dyzetvjetorin e Ushtrisë sovjetike për Leninin, etj. Me një vemendje të veçantë ai ndjek ngjarjet politike të kohës së sotme: luttën e guximëshme dhe të vendosur që po bëjnë në arenët ndërkombëtare Partia Komuniste e Kinës dhe Partia e Punës së Shqipërisë, për ruajtjen e pastërtisë së ideve të marksizëm-leninizmit kundër revizionizmit modern, miqësinë e Shqipërisë me Kinën e Madhe.

Poezitë e Sokol Arifit kanë një fryshtësim të gjërë dhe një stil shumëherë të tepruar (emfatik). Kjo i ka dhënë krijimeve poetike të tij edhe një karakter recitativ, veçori që nuk ka qenë e zakonëshme në të kalluarën. Ato jo vetëm që këndohen, duke u shoqëruar me instrumentin karakteristik të Veriut, lahutën, po edhe recitohen, para mbledhjesh publike, në çfaqje popullore, në festivalë etj.

Talenti i këtij rapsodi të ri premtón shumë për të ardhmen.

**LUFTA E KRASNIQES KUNDRA  
PASHE MAXHARRIT**

Kur sultanët e Stamollit,  
nisin pashë, nisin ordi  
në Shqipni kundra popllit,  
për me i vra e pér me i gri,  
5 Pashë Maxharri, zogi i shkinës,  
ai përpara i pri ordisë,  
paska dalë n'Qafë t'Morinës,  
ja ka ngrehë topat Malsisë. (1)  
Don Malsinë pér me e çkrumue  
10 he, ata zoti e pastë marrue!  
Pashë Maxharri kqyr sahatin  
me marrë topat e msy Dezdarin,  
mi Dezdar pushoi n'at kodër:  
— Po ku t'kam, Krasniqja e vogël! —  
15 S'jam e vogël, po jam sa deti,  
Gash e Btyç i kam me veti,  
ma she' sherrin n'Stamoll mreti! —  
Pash Maxharri fol nji fjalë,  
i kërkon do bajraktarë:  
20 — Jau ka lypë mreti ka j djalë,  
no pér (2) burg, no pér ushtarë. —  
Binak Alia foli nji fjalë:  
— O maxharr, ti ma kadalë,  
se qetu i thonë popull shqiptar,

---

1) Malsisë së Gjakovës

2) ose pér (ndo pér).

- 25           ta dhashë besen, s'dredho i gjallë,  
       ke me metë si noj mullarë,  
       mjedis fushe si s'ka barë,  
       karajfil, pa currni ushtar.  
 Pash Maxharri asht idhnue,  
 30           në Dezdar aj kenka shkue,  
       urdhnoi topat e i ka gatue,  
       filloi kullat po m'i gjue,  
       kulla t'mira me harasan,  
       kurrgja topi nuk po u ban,  
 35           kulla t'mira, kullat e Fangit,  
       gja s'po u ban topi i Sulltanit.  
       Ju dha lajmi krejt katunit,  
       n'rranxe t'Grisë e n'arë t'Kolë Kurtit,  
       n'Qafë t'Kobiles e n'Shkallë t'Magjupit,  
 40           me liftue kunra turkit.  
       Bien malsort tanë çeta-çeta,  
       kanë lanë dhi e kanë lanë edha,  
       kanë lanë lopët me gjithë vjeta,  
       janë betue n'bé të veta:  
 45           — S'ja bajmë Pashës tungjatjeta! —  
       Janë betue n'bé t'ati vaktit:  
       — Pasha diten e bajramit,  
       tridhetë dit' e ramazanit,  
       s'ja ul qafen Pashë Maxharrit,  
 50           pa shkue gjaki der n'bark t'kalit! —  
       — Kush e thei luften tu kryqi?  
       — Shtatë malsorë zemrat çeliki,  
       kanë mustakt posи kreshniki:  
       — Muzi Zeqiri, Rustem Zeqiri  
 55           Bek Sadiki e Zenel Sadiki.  
       Luft' e madhe në ket Malsi,  
       treqin shpi me nji ordi,  
       shum kanë vra e shum kanë gri,  
       pjesh' e madhe e vrau katuni,  
 60           ata tjert i mori lumi.  
       N'Shkam t'Dezdarit, nji rrasë e bardhë,  
       po kuvendon vala me valë:  
       — Ti, moj motër, ngomë nji fjalë:  
       — Kur të vinë turqit në zallë,

65 sallte nja mos ta lshojmë gjallë,  
 Pashë Maxharri kryet si hut  
 kanë ardhë t'u digjet baruti  
 sot më çkrini arrnauti.  
 Pashë Maxharri e ka marrë nanen  
 70 e ka Ishu Dezdarin naten,  
 siç i tha Binaki parë,  
 karajfil pa kurjni ushtar.  
 O Sulltan, ty t'shoh budallë,  
 s't'vye gja lufta me shqiptartë,  
 75 ne t'i vramë të tanë ushtartë,  
 atherë kthehesë e çon dhuratë,  
 dymdhetë lira për nji pojatë. (1)  
 Ku kanë rrahë gjylet e topit,  
 sot punojnë thikat e traktorit,  
 80 grun' e drithë po i jep popllit!

## 2

### MIC SOKOLI N'DY TAGANA

Mic Sokoli n'dy tagana,  
 — Udhamarë, m'i ka thanë nana,  
 lufto, bir, ti për Shqipni  
 mos i len turqit me hi;  
 5 n'koftë nevoja, vi me ty. —  
 Mic Sokoli ni fjalë po e flet,  
 po i thotë nanës: Të mirë meç!  
 pa u farue malsia krejt,  
 ktu nuk hi krajl as mbret!

---

1) Çka u ba dam, e pagoi Turqia mbas luftës me Pashë Maxharrin. Pagoi edhe pojatat (kasollet) e dhive.

## BAJRAM CURRI N'SHPINË T'ATKISE

Bajram Curri n'shpinë t'atkisë,  
me za t'fort po i thrret Malsisë:  
— Ju mos shkoni mas parisë,  
se e kan fik' tokën e Shqipnisë.

5      Kta parija janë tradhtarë,  
shesin venin pér dollarë,  
pér atdhe dert nuk kanë.  
Bajram Curri, trim me fletë,  
ky gjithmonë ka majtë ni besë,  
luftoj serp e malazes,  
me Leninin â marrë vesh.  
Çka i ka thanë hazret Leninit?  
— N'Shqipni t'vogël, afér Pernimit,  
n'buzë të detit Adriatikit,  
do t'çaj rrugn e socializmit!

10     Po hajmedet pér ket Shqipni,  
ç'e pushtoj ky Zog' i zi,  
Zogu venin e ka pushtue.  
Bajram Curri, trim drangue,  
brraf ja bani, n'kamë â çue:  
— Ju, malsorë, hajdeni me mue,  
manarkinë, ka thanë, s'e due!  
Fill pej bjeshke â fillue,  
kunra Zogit me luftue.

15     Bajram Curri maje thepit,  
luftë po bajke kunra mretit,  
me malsorë si i ka me veti.  
Borë e madhe kishte ra,  
ranojnë ahat pér m'u çà,  
vijnë tradhtarët pa ja da,  
nja mas njai Gryks Dragobisë,  
ç'e vranë Burrin e Malsisë,  
e vranë plakin e Rinisë.  
Po ardhka lajmi n'bjeshkt t'Gurit:

20     25     30

35 — Hini Talja <sup>(1)</sup> n'port të Durrsit;  
 çohet Zogi pej kulltukit,  
 po i del fjala Bajram Currit!  
 Zogit t'Matit ja kem dhanë namën,  
 s'ka me e pa aj kurr Tiranën,  
 40 veç n'e paftë noj her n'anërr,  
 n'Amerikë e ka gjetë nanën.  
 Pak pranvera kanë kalue,  
 tanë Shqipnia u çlirue,  
 plot me lule u lulzue,  
 45 ni qitet t'ri e kem' marue,  
 emnin Curr <sup>(2)</sup>na ja kem' shkrue,  
 kurr Partia s'ka me e harrue,  
 gjithmonë Malsija ka me e kujtue.

4

### ME SHTATË PRILL KUR DOLI ZANI

Me shtatë prill, kur doli zani,  
 n'Romë t'Itales u ba denami,  
 u nis fashizmi, haj i hupt nami,  
 kis vndue <sup>(3)</sup> n'krye pendla pej kanxhi.  
 5 N'port te Durrsit paska dalë,  
 me e robnue popllin shqiptar,  
 po shum' krisi atherë potera,  
 u çuen shqiptarët trima me vlera,  
 ra fashizmi me krye n'therra;  
 10 për Shqipni na ka dalë vera,  
 u zhduk traththari e i keqi,  
 Duçen e Hitlerin i ka marrë dreqi.  
 Dielli i kanshëm i ka ra Shqipnisë,  
 u ra fshatarve e puntorisë,  
 15 u ra malsorve të Malsisë,  
 u ra çobave të bagtisë,  
 proletarve t'tanë Shqipnisë.

1) Italiјa

2) Qyjeti Bajram Curri, qendër administrative e rrëthit të Tro-pojës.

3) Vendue, vu

## E Ç'JANË KËTO PUSHKË QI PO KËRCASIN

E ç'janë këto pushkë qi po kercasin  
tak e tuk neper kto male?

— Thonë: shqiptarët janë çue në kambë,  
kanë ngre çetat partizane!

5 Thrret nji za nga maja e malit,  
za i fortë i partizanit:

— Eni burra n'fushë t'mejdanit,  
t'ja u bajnë vorrin Itales e Gjermanit,  
e t'i zhdukim tradhtarët e vatanit,  
lirinë e plotë t'ja sjellim shqiptarit.

10 Doli flaka e doli tymi,  
krisi pushka, u hodh kushtimi,  
tan Shqipnia në mal hyni,  
u tund Roma, u dridh Berlini.

## DILL I BUKUR I RA MALSISË

Dill i bukur i ra Malsisë,  
t'ri e t'reja kâkan nisë  
nëpër çetat e ushtrisë,  
për çlirimin e Shqipnisë.

5 'Izet e gjasht t'mujit nandorë  
jan çue tre trima malsorë,  
i kanë rrokë armet në dorë,  
luftojnë n'shi, luftojnë n'borë,  
për pushtetin popullor.

10 T'ri e t'reja jan bashkue,  
n'katun Tplanit <sup>(1)</sup> tek jan shkue,  
ni organizatë e kanë formue;  
kanë lidhë bes, janë besatue,  
për liri për me luftue.

---

1) Katund në jugë të Kolgecajt. Këtu u formue më 26 nëndor 1943, organizata e rinisë komuniste të Tropojës. Të nesërmën u formue batalioni i rinisë me Jah Salihin në krye.

15 Kshtu kanë thanë t'reja e t'ri,  
 ma s'jetohet n'borgjezi,  
 do t'luftomjë na pér liri!  
 Sa nis drita me u zbardhue,  
 i bataljon e kanë formue;  
 20 bataljoni tanë me t'ri,  
 Jah Salihi po m'u pri,  
 jan betue në parti:  
 — Do t'i xamë gjermanët me i gri. —  
 Shkueka lajmi n'Gjermani.  
 25 Nisë kolonat me ushtri  
 pér me e djegë t'çkretën Malsi.  
 N'qome t'Fangit, n'rranxa t'Grisë,  
 ç'po lufton Jaha mas avllisë.  
 Trimi i fortë pej Malsisë,  
 30 po jua ban Jaha me gisht:  
 — S'jam fashist, as jam nazist,  
 po jam malsuer komunist,  
 e merr vesht sot gjith Evropa,  
 pér atdhe na bahem' copa! <sup>(1)</sup>  
 35 Thirrëka Jaha si luani,  
 n'maje t'malit i vojti zani.  
 — Mos kaj, babë, o Sali Mani,  
 pa derdhë gjak, s'lirohet vatani!  
 Të gjithë shokët e Partisë,  
 40 janë të lidhun gisht pér gisht,  
 sikur hallkat e gjemisë;  
 Në Shqipni, deri n'tokat t'Rusisë,  
 ja biem t'ligën Gjermanisë.  
 N'mal t'Tomorrit, n'maje t'Shkelzenit,  
 45 luftojnë trimat e Enverit,  
 per çkatrrimin e Hitlerit.  
 Ushtrija e kuqe e Leninit,  
 ç'pejt do t'hijë n'porta t'Berlinit.

---

1) Vargjet 30-34 i ka marrë nga një kangë që ka pasë magritë pér Jah Salihin Zef Avdia (tjetër rapsod populor i Tropojës).

## O PARTI O NANA JONË

Nji fjalë due për me thanë, .  
ta nijojnë shqiptart' n'çdo anë,  
n'Durrës, Vlonë, deri n'Tiranë,  
Gjinokastra me tropojanë,  
5 Korça plakë me gjithë shkodranë,  
Mat' e Dibër edhe lumjanë,  
për Shqipninë si gjithmonë â kanë,  
si 'i fmi i vogël si s'ka nanë,  
10 si nji foshnje jetim, tmerrue,  
si nji lis në pyll i rrxue,  
lis i rrxue u mushë me t'zi,  
gjithkush vjen po i shkelë përmi.  
Por, dritë t'bukur tash ban hana,  
s'ka beglerë, as kapidana,  
15 lumte na, na lindi nana,  
le na ka nji e dashun nanë,  
n'nji shpi t'vogël në Tiranë.  
Kjo asht nana e tanë Shqipnisë,  
nanë e dashtun e vegjelisë;  
20 kjo asht nana e shqiptarit,  
e puntorit, e katundarit,  
nanë e t'ziut e nanë e t'bardhit,  
nanë e dashtun e krejt popullit,  
e qytetarit, e malsorit,  
25 Kjo trimnesha e xhixhanit,  
n'luftën e dytë të Partizanit,  
dangë të madhe i dha gjermanit.  
Puna sot e tregon me fakte:  
Ku kan kenë ujna e moçale,  
30 i kthej n'fusha e ndërtoj kanale,  
ku kan kenë lumej me valë,  
sot valojnë hidrocentralë,  
për qytete, kodra e suka,  
sot kalon hekurudha.

35 Nëpër boka e kodra t'blera  
nxjerrin krom nëpër minjera.  
O Parti, o nana jonë,  
fal te koshim përgjithmonë,  
gjithë të drejtat sot po i gzojmë,  
të kem nanë, e na ke birë,  
40 Rrnofsh sa malet, moj Parti,  
si na flake ket zinxhire  
e sot populli jeton i lirë!

### LIRI E DRITË NA DHA PARTIA

Sot nuk janë krizmat e hutës,  
po janë tingujt e lahutës,  
milodinat e Malsisë  
5 si lavdi po i kndojnë Partisë;  
po i kndojnë nji kangë të bukur,  
kujtojnë terrin si kaloi,  
i kndojnë dritës si agoi  
dhe Partisë qi i edukoi.  
Thot malsori, or tungatjeta,  
10 kur ish Zogi me men t'leta,  
me rrugë t'gjata plot me kthesa,  
plot me vrasje dhe ngatrresa;  
atherë ishin n'fuqi paritë,  
15 ka pesë vetë u vrajshin n'ditë,  
u ngatrrojke nji mahallë,  
nana e çkretë metke pa djalë.  
Kjo, s'ish rruga e Partisë,  
me ja vra baben fmisë,  
me e ba vajn' e me e ba gjamën,  
20 me e vra djalin e me e lanë nanen.  
Vendi ynë ë vend malor,  
bjeshkë të nalta veshë me borë,  
sikur nuset me kunorë.  
Ktu n'vend tonë, o more vlla,  
25 ishin kanë do pylla t'mdha,

hajren kush nuk ja pa  
ku n'at pyllë s'shkojke shtektari,  
as m'at pyllë s'shkojke gjuetari,  
as m'at pyllë s'shkojke çobani,  
30 se aty fjetke kusari  
e aty u vrajke fshatari.  
Partija jonë ka marrë vendim:  
— Gjithë kto pylla, të vihen n'prodhim, —  
Tash do u thom nji histori:  
— Në Kolgecaj aty përmi  
35 aty gja s'pash me sy,  
veç tre blina e nji bojli  
nji dugaj, e nji xhami,  
por tash larg pej n'kodra t'Drinit,  
40 duken dritat e elektrikit,  
fund i bjeshkave t'nalta t'gurit,  
asht qyteti i Bajram Currit.  
Po të ngjitesh në qafë të Luzhës,  
duket pallati i kulturës,  
45 po të hypësh majet malit,  
shohim shkollën e gjymnazit.  
Sot Malsija me men t'holla,  
s'ka katun si t'mos ketë shkolla.  
Lum po ban pra kjo Malsi,  
50 si u ba qytet i ri,  
me spital, dispanseri,  
me doktora e me mami,  
tashti kem dhe radiografi.  
Lum e lum po ban Malsija,  
55 liri e dritë na dha Partija!  
Zogit t'Matit i ka ra lija,  
bashkë me ta diqën parija  
e me Zogin iku terri,  
cofi Duçja e Hitleri  
60 n'gradn' e funit â Kenedi,  
Tito horrin e ka prekë vneri,  
se n'krye t'popllit drejton Enveri.  
Lavdi nanës Parti si e rriti,  
fukaranë n'dritë e qiti!

## LAVDI THURRI PARTISË NANE

Të kisha zemrën e gjanë sa deti,  
me fuqinë e nji tërmeti,  
me i këndue këtij pushteti!  
Natë e ditë rri tue mendue,  
po rri vargje tue rreshtue,  
po rri kangën tue këndue.  
Fluturo pra, mori kangë,  
mbi kto troje anembanë,  
lavdi thurri Partis' nanë!

Nuk mbaron kjo kanga ime,  
rrjedh si ujë ndër burime,  
m'u mbush zemra plot frysime,  
kur e shoh Shqipninë tue qeshë,  
petka të reja paska veshë,  
si dikur ndonjë mbretneshë.

Ligjiron kanga e bylbylit,  
çelë petalja e drandafilat,  
tunden valët e Adriatikit.

Nandmbëdhjet vjet çlirim janë mbushë,  
pra këndo, o mal e fushë,  
nji gjerdan e kanë n'gushë,  
nji gjerdan margaritarë,  
qi ja dhanë kta pesvjeçarë,  
ja dha populli shqiptarë.

Sot nan diellin e Partisë,  
ju hap rruga ditunisë:  
Çeli mendjen e njerzisë.  
Anembanë atdhenë e mata,  
kukund s'gjeta injoranta,  
dalë rinia maturanta.

Në Shqipni nuk ka ma therra,  
se tek ne ka ardhë pranvera,  
u mbush vendi inxhiniera.  
Sot po zgjohen malet tonë,  
lum Shqipnia e lum Tropoja.

3926

O Valbonë, Valbonë e bardhë,  
që po dirgjesh valë-o valë,  
sot ti Drinit çomi fjalë:  
mjaft e humbe jetën kot,  
tue e pa Shqipninë në lot,  
40 Dita jote erdhi sot;  
se për ty tash erdhi dita  
me e mbushë vëndin me drita,  
ku jetojnë shqiptarë-petrita.  
O Shqipni, moj zojë e randë,  
45 në gjithë botën more famë,  
ta ndigjojnë sot zanin tand,  
në Afrikë e në Azi,  
në Amerikë, Australi,  
që nga jugu në veri!  
O Shqipnia e vërtetë,  
50 e pavdekshme ke me mbetë,  
ti sa malet rrofsh për jetë!

10

### TREMBËDHJETË VJETORI I ÇLIRIMIT

Në Shqipni ditën e sodit,  
lum po ban gjithë masa e popullit,  
qi u afrue muej Nandorit,  
erdhi dita e tremdhetëvjetorit.  
Ditë e gëzimit e gjithë popullit,  
5 si iem clirue prej akupatorit,  
klikë të keqe ka pasë hori,  
na i preu foshnjet mjedis oborrit,  
mrendë familjet na i shkrumojti,  
kush kje plak jashta s'doli,  
10 ja kështu e kishte hori,  
si Italja ashtu dhe Zogi.  
Klikë e keqe, klikë e tyne,  
do t'i flas disa mendime:  
15 — Shumë kem' vuejtun në mjerime,  
me masakra e torturime,  
me vllavrasje e burgime,

fort ka vujtë e shkret Shqipnia,  
ka bejlerët e ka paria,  
qi nga Zogi e nga Turqia,  
ka Gjermani e Italia,  
ishte shtypun grueja e fëmia,  
për me folë s'guxonte rinia,  
fort e mjerë kjo rini,  
20 tash po flasin për Shqipni:  
— Tremdhetë vjet demokraci,  
populli i qetë rron në liri,  
kush rushfetin s'e kqyr me sy;  
s'punon hatri me miqësi,  
30 punon ligji me drejtësi,  
U lulëzue kjo Shqipni  
me fabrika për bukuri,  
kurr s'i kam pa besa me sy,  
veç se u formue kjo Parti.  
35 Kem' fabriken tekstilit,  
me emnin e Josif Stalinit,  
në mes t'Kasharit e Yzberishit, (1)  
stof e bez i jep tan' Republikës,  
Republikës e krejt miletit.  
40 Shif çentralin me emën Marksit,  
mbi lum të Matit afër Burrelit,  
ku jep dritë Shkodërs e Lezhit,  
jep Milotit edhe Rrëshenit.  
45 n'grykë të Shëngjinit e n'buzë të detit  
der ke Kruja e Skenderbegit,  
jep Tiranës kryeqytetit,  
e çon dritën larg n'Mirditë  
dhe kudo në Republikë.

---

1) Kombinati i tekstilit J. V. Stalin i ngritur në zonën industriale Kashar-Yzberish.

## RROFTË PARTIA E PUSHTETI

- Nji nandor pesdhjetë e shtatë,  
kur leu drita, daltë e bardhë,  
me shumë gëzim e me nafakë  
për marë popullin shqipëtar.
- 5 Gzim për popullin e krejt miletin,  
valë të bukur sot sjell deti:
- Rroftë Partia e Pushteti,  
na i hoq triskat prej xhepi,  
plot me bukë dyqani i shtetit,  
plot me bukë dyqan' i ri,
- 10 rroftë sa malet kjo Parti,  
mirë në luftë kjo na ka pri,  
fituam dritë dhe liri,  
Plak' i moçëm asht çue n'kamë
- 15 nji fjalë të bukur ma ka thanë:  
— Tetdhetë vjet sivjet i kam lanë,  
ma lirë bukën kurr s'e kam ngranë!  
Unë i mbusha tetdhetë vjet,
- 20 jeta m'shkoj për gazep,  
herë nën krajl e herë nën mret,  
s'i kam përpjekë kurr, këmishë e brekë, (1)  
por rrnoftë Partia e koftë e bardhë,
- 25 rrobe të reja dy tri palë,  
bukën lirë tashti po e hamë.  
Vojtë ka fjala ka Amerika,  
se n'Shqipni mrrini e mira;
- 30 socjalizmi s'asht me brina,  
po, me fabrika e me uzina,  
bukë bollek e gjana t'mira.

---

1) Nuk kam veshur kurrë këmishë e të mbathura të reja në  
një kohë.

## KONGRESIT TË IV-të TË P.P.SH.

Lajm i bukur nga Tirana  
 an'e m'anë iu dha Shqipnisë,  
 valon puna e buçet kanga  
 për Kongresin e Partisë.  
 5 Lumja ti, o moj Shqipni,  
 diell i bukur leu për ty,  
 kurr ma e mirë ti nuk je kanë,  
 si u bane nji ven me famë.  
 N'maje e n'shkrepa t'atdheut tonë,  
 10 prej Vjosës deri n'Valbonë  
 dhe Gramozit deri n'Vlonë,  
 e lirë shqypja fluturon,  
 n'katër qoshet e Republikës,  
 n'fusha e n'male të Malsisë  
 15 buçet kanga e rinisë,  
 për kongres t'kater t'Partisë.  
 Malsort tanë s'e njohin tuten,  
 «n'ni dorë kazmen e n'tjetren pushken!»  
 N'pik t'sabahit e ms...në fushën,  
 20 mrojmë atdhenë, e sigurojmë bukën.  
 Sot n'malsi punojmë me vrull,  
 i madh e i vogël, gru e burrë,  
 siguruem misër e grunë,  
 kemi msue edhe kulturë.  
 25 Kjo Shqipnija e jonë kreshnike,  
 kurr anmikit s'ju nenshtrue  
 dhe gjithmonë me armë në dorë  
 kundra t'hujve kem' luftue.  
 Gjithë Shqipnija sot ka nji besë,  
 30 jem' të lirë punojmë serbes,  
 mrojmë atdheun me kujdes,  
 faqebardhë dulem n'Kongres.

## LUM PO BAN POPËLI SHQIPNISË

Lum po ban poplli Shqipnisë,  
 nizet vjet nen hie t'Partisë,  
 si shpëtuem pej borgjezisë,  
 e sa bukur ndriton qielli,  
 rreze t'arta sot lshon dielli,  
 5                       çeli lulia dranafilli  
 e në pyll po kndon bylbyli,  
 e në fushë punon traktori,  
 e n'fabrikë po kndon puntori;  
 10                      kndon puntori në fabrikë:  
 — Rrnoftë Partija si na dha dritë,  
 sot po i gzojmë tetë orë në ditë.  
 Edhe sot pra në Shqipni  
 dekë beglerë edhe pari,  
 15                      s'ka fshatarë as puntori,  
 t'jenë rrrogtarë e sot çipçi.  
 Partija jonë tundi Evropën,  
 ja dorzoi fshatarit tokën.  
 Partija jonë s'e diti frigen,  
 20                      ja ka qitë anmikit piken,  
 ja dorzoi puntorit fabrikën.  
 Sot puntorët parakalojnë  
 me flamur të kuq në dorë,  
 Rrnoftë sa malet, nana Parti,  
 25                      hoq shfrytzimin për gjithmonë  
 nga njeriu në njeri!  
 ... Kush na i bani pyllat fusha?  
 Kush na i molli therrat rrusha?  
 Nepër kodra e brigje e suka,  
 30                      kem' mjellë molla e dardha t'buta.  
 Kush e zhduki kudo malarjen  
 e i thau tanë kto moçale,  
 e i ngriti kto hidroçentrale,  
 e i bani tanë kto kanale?  
 35                      Sot po pvetin t'rejat e t'ritë:  
 — Kush e mloi Shqipninë kaq rriptë,

e ja priti t'gjitha piktë.  
 Fort t'sigurt i kem' kufitë,  
 s'mund na i trembin kurr anmiqtë.  
 40 Ushtrija jonë në kufi,  
 pushken në dorë, dylbitë në sy  
 e pa fietun kurriherë! —  
 Çka tha plaki maje thepi:  
 — Rrnoftë Partija, rrnoftë pushteti,  
 45 syni em sheh pértej detin.  
 se e kam zhdukë analfabetin.  
 Sa me gzym e pres pranveren,  
 pér çdo ditë lexoj gazeten,  
 Kush e zhduki Gjermaninë,  
 50 kush e mbyti Italinë,  
 po kush vall buzqeshi fminë,  
 e edukojti gjith rininë  
 e e lulzojti krejt Shqipninë  
 e e ngriti industrinë?  
 55 Kush ja dha popllit lirinë?  
 Enver Hoxha me Partinë!  
 Manej thuhen ca fjalë t'vjetra:  
 Çka lyp zogla e bjen pranvera!  
 Çka e ka lyp gjithmonë Shqipnija,  
 60 sot në dorë na e dha Partija!

## 14

### DRAGOBISË

U fillova prej qytetit,  
 pér me u ngjité në majë të thepit,  
 pér me dalë ku vloj baruti,  
 ku luftonte Bajram Curri.  
 5 Dola nalt, në Dragobi,  
 ku ish ba katundi i ri,  
 dy gish qiell kishin pérmbi,  
 maje të mprehta si singi;  
 rritet ahu me qetinë,  
 10 rrjedh Valbona në lugine,  
 ndan katundin në dy pjesë,

15

por të gjithë e kanë nji besë;  
kan nji besë e kan nji fe,  
me dhanë jetën pér atdhe.  
Dragobia në vend të thellë,  
aty nderi s'asht pérlye,  
kryet anmiqve ua ka thye.  
Po kështu si Dragobia,  
asht e fortë e tanë Shqipnia!

15

### PESDHJETË VJETORI

- Drita duel, dielli ka ra,  
pér shqiptar ma terr nuk ka,  
U zhduk mjegulla e tufani,  
nga themelet u çkul Sulltani,  
diq Italja e gjermani,  
tetmdhetë vjet u çlirue vatani,  
u çlirue atdheu jonë,  
nji herë e mirë e përgjithmonë.  
Kam nji fjalë me ja thanë rinisë  
si mas ngjarjeve t'historisë,  
ka vuejtë populli i Shqipnisë,  
pesqind vjet nan thundrën e Turqisë,  
Mjedis turkit ka ra 'i rrfe:  
Erdh Skenderi, ku ka le!  
Kush ja myti orditë Sulltanit?  
Skanderbegi heroi i komit,  
i biri i Gjonit, trimi me fletë,  
ka liftue njizet e pes' vjet,  
per Shqipni e atdhe t'vet.  
Ra rrufe n'shkrepa t'Shqipnisë,  
zani i Enverit e i Partisë,  
zani i fortë i popllit shqiptar,  
si tingllon sot n'boten marë;  
tok' e quell, fusha e male,  
po me duket si po kendojnë.  
ka Shqipnia nji festë t'madhe  
qe sivjet do ta festojmë.  
Me njizet e tetë Nandor,

po plotsohen pesdhetë vjet  
 si u ngrit flamuri në Vlonë  
 i shqiptarve të vërtetë.  
 O ku je, Ismail Qemali,  
 zemershkam e mendehollë,  
 në duer tua xhevahir,  
 e ke ngritë flamurin n'Vlonë.  
 O Ismajl, o baba i parë,  
 për ty po këndon poplli shqiptar:  
 — Rapsod, poet, kangtar e shkrimtar. —

16

**NDËRTOJMË SOCIALIZMIN  
LULZOJMË SHQIPNINË**

Shum na janë kanë çue zagart e Evropës  
 sikur qentë mi rrashthin e lopës,  
 mbretina e krajla vishin pa ja da,  
 Shqipninë tonë me e shtypë e me e përçë,  
 diellin e dritën s'na e lajshin me na ra;  
 5 por sot populli i Shqipnisë,  
 diell e dritë i ka gjetë prej Partisë!  
 Toka e shqiptarve ë kanë e vërtetë,  
 si hala e peshkut gjithmonë n'fyt u ka metë.  
 Kush e ka msy token e Shqipnisë,  
 10 fike e marre gjithmonë i coi shpisë.  
 Shqiptarët tanë janë kanë trima si zana,  
 pa exhel te hujtë i bajnë si t'i kajnë nana.  
 Në malet e Krujës, te fusha e Torvollit,  
 15 n'portat e Durrsit, n'malet t'Kastriotit,  
 hala gjinden rashtat e ushtarve t'Stamollit;  
 në kodra e n'brigje, n'male t'Shqipnisë,  
 hala gjinden pendlat e kanxhave t'Italisë; (1)  
 te Guri i kuq, te Vajza e Kastratit,  
 20 hala ndihet era e stervinave t'Beligradit.  
 Po le t'gjimojnë detet, le t'tunen vullkanet,

---

1) Aluzion te bersalierët italjanë që mbajshin pupla në helmeta.

le t'dëgjojnë grekët, serbët e italjanët,  
të ndjej revizionizmi edhe ata si e pasojnë,  
se na populli shqiptar, planet po i realizojmë.  
25 Përpara, përpara, pra popull shqiptar,  
burra e gra, t'ri e t'reja marë,  
n'fabrikë, n'uzinë, n'kantjer apo n'arë,  
për nder të planit të tretë pesvjeçar!  
Me duer t'herojve t'shqiptarve t'vertetë,  
30 ta bajmë planin tonë të ngrihet si n'raketë,  
se babë kena Enverin, nanë kena Partinë,  
ndërtojmë socializmin dhe lulzomjë Shqipninë!

17

### VOTIMET E 3 QERSHORIT 1962

N'rrasë t'Shelzenit po knon zana,  
lajm të ri ka nxjerrë Tirana,  
nga Tirana lajm' i ri,  
tre qershori gjashtdhetedy  
5 bahan votat në Shqipni.  
Ka pesë herë, o more xhan,  
si votojmë t'lirë edhe sovran.  
Çka kanë malet si gjimojnë?  
Çka kanë fushat si jehojnë?  
10 Janë shqiptarët kah punojnë,  
kangës s'bukur po ja thonë,  
tre qershori e kujtojnë,  
kur at ditë si do t'votojmë,  
votat frontit ja dorzomjë,  
15 dhe anmikit i tregojmë,  
t'hekin shpresë prej atdheut tonë!  
Ç'tha malsori n'maje t'malit?  
— Votat tona janë të frontit,  
plasim zemrën diversantit.  
20 Marinari, n'valat t'detit,  
falmeshnet po i ban Enverit:  
— Votat tona janë t'pushtetit.  
Ushtari jonë sot në kufi,

26

pushkën n'dorë, dylbitë në sy,  
 25 i pafjetun kurriherë,  
 tanë anmique po u ep tmerë,  
 n'piramidë aj â betue:  
 — S'kâ anmik ktu me kalue.  
 un per frontin due me votue.  
 30 — Lum e lum, sot ban fshatari,  
 si u kthyje puna për s'mari,  
 si i ziu edhe i bardhi,  
 si puntori dhe katunari,  
 si nëpunci e arsimtari,  
 35 oficeri dhe ushtari,  
 i kem t'drejtat barabari.  
 Duel malsori nji fjalë pe e flet:  
 — Rrnoftë sa malet ky pushtet,  
 rrnoftë Partija si na dha t'dreitë,  
 40 qesim voten ku t'domë vetë,  
 per te dashtunit deputetë!

18

### LUM PËR TY MALSIA IME

Lum për ty, Malsia ime,  
 5 qi na mbushë zemrën me gëzime,  
 je e bukur porsi hana,  
 bjeshkë të nalta, fusha të gjana,  
 në kto bjeshkë veshun me borë,  
 ku u rrit plaki malsorë,  
 në gjinin tanë na u rrit burri  
 Plaki i maleve, Bajram Curri.  
 Kur në pritë u ulka plaki,  
 10 kristë pushka e derdhej gjaki.  
 Kur malsori jepte besën,  
 parasyshë s'e muer pengesën,  
 mbajti fjalën porsi burrë,  
 në duer anmikit s'i ra kurrë  
 15 dhe qëndroi si shqipe malit  
 bir i shtrejtë i kti vatanit.

Sa të hieshme malsitë tonë,  
ato kurr nuk i lshon bora,  
piqet dardha e skuqet molla,  
atje rritet vetullholla.

### JA PRA SHOKË MALSIA IME

Ja pra, shokë, Malsia ime,  
si ka lind në luftë vigane,  
bujareshë, moj nana ime,  
në çdo luftë nam ke lanë.  
Kujtoj Grykën e Dragobisë,  
ku atje ka luftue «Burri»  
për çlirimin e Shqipnisë,  
i thonë për emën, Bajram Curri.  
Jam malsor pej Malsisë,  
dyzet vjet hala s'i k'mushë,  
kujtoj t'mirat edhe t'kqijat,  
no pér mal e no pér fushë.  
Kujtoj ushtart e Gjermanit,  
si na banë shkrum e hi;  
kujtoj çetat e partizanit,  
si na dhanë dritë e liri.  
Mu m'kujtohet miniera e Kamit,  
si u çfrytzojke ka Italija,  
sot punojnë trima malsorë,  
tanë prodhimet ja merr Shqipnia.  
Kujtoj pyllin e Cerrnicës,  
si ja nalke rrezet diellit,  
tash asht ba nji fushë e bukur,  
plot malsorë pej Dukagjinit.  
Kujtoj lumin e Valbonës,  
me valë t'vet ma bardhë se bora;  
kujtoj çikat e Tropojs,  
i kanë faqet kuq si molla,  
gjith Malsija u mush me gjim,  
tokat zbashki i kem bashkue;

djel e çika në prodhim,  
 tanë Malsija ka përparue.  
 Kur ish Zogi me «men t'holla»,  
 ish Tropoja me shtatë shkolla,  
 35 por tash e di i gjithë miletin,  
 pesdhetë shkolla i ka rrethi,  
 kur po venë trimat malsorë,  
 shum nëpunsa dhe puntorë,  
 vinë e shkojnë me libra n'dorë,  
 40 bile zbresin dhe pej malit,  
 shkojnë në shkollën e gjymnazit.  
 Per nji gja m'vjen shum lezet:  
 «Krejt Malsija u lulzue,  
 fshati ynë u ba qytet!» . . .

45 Ish e shtypun e shkreta Malsi,  
 kur ish Zogi në fuqi;  
 për malsorë z'dritojke dielli,  
 as për ne s'knojke bylbyli,  
 as për ne s'lulzojke prilli,  
 50 s'kishim rrugë automobili,  
 metë pa drita alitriki.  
 Por tash nalt n'male t'Tropojs,  
 larg po i nihet burija «Skodës.»  
 N'Shelzen t'Gashit e n'rranxe t'Grisë.  
 55 buçet lugu i Malsisë,  
 pej traktorve, puntorisë.

20

### C'KA MALSIA TUJ GJIMUE

Nii fshatar në kamë â çue,  
 vall kush din për me m'kallxue  
 c'ka Malsia tuj gjimue?  
 Asht traktori tuj punue.  
 5 Krizem e bukur. krizm' e traktorit,  
 sot po i prish pyllat e Zogit. (1)

1) Bëhet fjalë për hapjen e pyllit të Cernicës që ka qënë pronë shtetnore në kohën e regjimit të A. Zogut.

Ktu n'vende ton, more vlla,  
ko ka kanë do pylla të mëdha,  
por Partia muer vendim  
10 për me i vu t'gjitha n'prodhim.  
Atje n'vend ku ka kenë çungi,  
fjetke derri, fjetke uki,  
sot, valon kalli prej gruni.  
Atje n'pyllë te ka kenë <sup>(2)</sup> lisi,  
15 fjetke dhelpna dhe iriqi,  
sot valon kalli prej misri.  
Në Cerrnicë traktori mrrini,  
flet nji plak prej Dukagjini:  
— Merrni vesh, burra sa t'ini,  
20 kshtu ndërtohet socjalizmi!  
Budo Isufi, trim hero,  
dit' e nat' me traktor n'dorë.  
Ky djaloç â çue në kamë,  
nji fjalë të bukur e ka thanë:  
25 — Tropojanve u baj selam,  
bung në kamë nuk kam me lanë,  
i rrwoj lisat tanë për dhe  
dhe s'e la asnja për be.  
Bungi i moçëm nji fjalë ka thanë  
30 për rrezikin si e ka xanë:  
— Treqin vjet sivjet kam lanë  
m'ka rrezue dielli me hanë,  
m'ka rrähë breshën, borë e tufan,  
m'ka ra borë e m'ka ra shi,  
35 m'kanë shkelë krajla me ushtri,  
vet sulltani me ordi,  
me ordi sulltani asht kanë,  
bung se bung kam ndejë në kamë.  
Edhe veti i kam pa thanë,  
40 me m'ra top kurrgja s'më ban;  
s'më ban gja gjylja e topit,  
kuku i mjeri, diten e sodit,  
si më preu thika e traktorit!  
Kur traktori ra n'Cerrnicë,  
45 disa njerz kanë pa' pritë,

---

2) Për trajtën qënë.

se kjameti ka me krisë,  
por kjo fjalë, s'ishte kanë gja,  
fushë e bukur tash u ba...  
Vendi ynë demokraci,  
pa beslerë e pa pari,  
as ka krajla, as mbretni,  
s'i len pyllat ma n'qeti,  
po i punon për popullsi.

### KUR TINGLLOJ ZANI I PARTISE

5 Kur tinglloj zani i Partisë  
n'fshatra t'nelta të Malsisë,  
n'katun t'Markaje, afër xhamisë,  
në ni shpi t'vogël të Sadrisë, (1)  
larg u nis krizma e alltisë,  
ja thymë krijet burgjezisë,  
bash si n'venet e Rusisë.  
Kerset pushka koder n'koder,  
n'lagje t'Secit, n'Shkoder t'vogël. (2)

10 Larg ka shkue predh e çelikit,  
ja kan çkye goxhufin anmikit.  
Foli ara ene livadhi:  
— Sot u kthye puna për s'mari,  
u zhduk gardhi, ngatrestari,  
kolektiv u ba gjith fshati.  
Flet Galinxhi (3) pej n'qoshe t'gardhit,  
burr'i mocëm si plak vaktit,  
deri n'sylah poln e mustakit,  
me za t'fortë po i thrret privatit:

15

1) Sadri Shpendit: në shtëpi të tij u ba mbledhja për ngritjen e kooperativës së katundit Markaj.

2) Në këtë lagje janë disa shtëpi të mbledhura grumbull (në kundërshtim më shtëpitë e tjera që janë të shpërndara prej njëra tjetrës, këto quhen si lagje qyteti).

3) Galinxh Logu, plak 80 vjec, një nga përkrahësit kryesor të ngritjes së kooperativës.

20 — Hajde, burrë, bashkohem zbashkit,  
mos u tut, se z'desim unit! —  
Nana doli mun te pragi!  
— Sot për ne mrrini rehati,  
kolektiv u ba gjith fshati,  
25 rrnoftë kolkozi e dektë privati! —

22

### KËRCET MINA BAHET JEZER

Na fshatarët e Malsisë  
si jetojmë n'shkrepa t'Shqipnisë,  
karshi shtetit t'Jugosllavisë,  
kur vje' pika e mjesditës,  
5 gja nuk niejmë, veç krizma minësh.  
Kërcet mina, bahet jezer,  
e çajnë shkamin menjiherë,  
përshndetim shokun Enver!  
Përte' <sup>(1)</sup> Begaj <sup>(2)</sup>, more djalë,  
10 aty ndodhen trima shqiptarë,  
si po ulen me litarë,  
si po e çajnë shkamin e bardhë,  
t'ja çojnë fshatarit ujt n'arë,  
e t'ja çojnë ujt n'obor,  
15 grun' e misër të ketë boll.  
Grun' e misër n'venet tonë,  
rrnoftë Partia dhe Enver Hoxha!

---

1) përtej

2) Kënga flet për punimet që bëheshin në Begaj, për marrjen  
e ujit me të cilin vaditet sot fusha e Cerrnicës.

## N'ÇUKË TË PAQES N'SHKELZEN T'GASHIT

N'Çukë të Paqes, n'Shkelzen t'Gashit  
 knon bylbyli i lirisë,  
 bjem ma poshtë në vene t'ulta,  
 lug i bukur i Malsisë.

5 Za i fortë na paska dalë,  
 za, o zani i Partisë,  
 dalka zani ka Partia,  
 për me u mbledhun fshatarsia:  
 — Do t'formojmë koperativa!

10 Flet fshatari nji fjalë të mirë:  
 — Hajde, vllazen, me dëshirë,  
 tanë të himë në koperativë! —  
 Folën fusha e kodra t'blera:  
 — Rrnoftë sa malet, kjo Parti,

15 tash për ne, ka dalë pranvera,  
 ma nuk jem' në borgjezi.

U zhduk stani, ledh' e therra,  
 rrnoftë pushteti me Parti.

20 Fush' e bukur, pa rod stomi,  
 pa pengesë punon traktori,  
 kem' traktorin me dymdhëtë thika,  
 rrnoftë sa malet Republika!

## HIDROCENTRALI KARL MARKS

A nigjoni, trima shqiptarë,  
 shok'e shoqe vullnetarë,  
 t'ri e t'reja të pandarë,  
 si ndodhëm n'hidrocentral. (1)  
 5 Do t'i flas nja katër fjalë,

---

1) Në hidrocentralin K. Marks një pjesë e mirë e punimeve u krye nga brigadat vullnetare të rinisë, të cilat erdhën nga të katër anët e atdheut.

me sy t'mi un sa kam parë:  
Ne kemi lanë nanë e babë,  
babë e nanë te shpiat tonë,  
se e pamë se asht nevoja,  
10 për t'punue n'kto malet tonë.  
Po flet radjua pa ja da,  
po flet radjua lajme t'rana  
si po i sjell kah Tirana.  
Hidrocentral n'kto ana!

15 Vullnetari nji fjal' pe e flet:  
— Këtu e çojmë jetën për lezet,  
jetë të mirë po ban rinija,  
ket na ka sigurue Partia. —  
Punoni, djem, he u pastë Partia,  
20 u pastë Partia e Enver Hoxha,  
ta bajmë gurin copa-copa,  
për me u çuditë Evropa,  
me u çuditë Evropa krejt,  
jem' shqiptarë trima me fletë:  
25 ... kem ca shkamin në Shkopet,  
tash punojmë me dit' e netë.  
do ta kthejmë lumin përpjetë.  
Kanë pa' thanë ni fjalë trathtartë:  
— Hidrocentral s'un bajnë shqiptartë,  
30 rrugn e lumiit s'mun me nalë!  
O trathtarë, unë po t'thom,  
ti gjithmonë ke ba zakon,  
fjalë të kota bizedon,  
thue à i vogël poplli jonë.  
35 S'asht i vogël poplli jonë,  
s'bashku jem nanqin miljonë!  
Rrezja e diellit sa prek retë,  
në digë mina po kercet,  
gur e dhe po i çon përpjetë,  
40 trubullohet lumi krejt.  
Po t'shikojsh atje ka diga,  
ku punon djali e çika,  
prozhektori nëpër shtylla  
e ba' venin sikur del drita,  
45 rrnoftë sa malet Republika!

Republika e jonë popullore  
 si e solli poplli për dore  
 e arritëm të gjithë kto fitore.  
 Kemi mrritë fitore t'mdha,  
 giithë rinia punon pa da...  
 S'guxo' kush me na cenu!  
 nuk cenohet ma Shqipnia,  
 rrnoftë Enveri dhe Partia!

### ENVER HOXHA

Çka kanë malet e Shqipnisë  
 si ushtojn' kangët e trimnisë,  
 prej gojës plakit e t'rimisë,  
 si lavdi po i kndojn' Partisë  
 5      dhe udhëheqsit t'saj besnik,  
 Enver Hoxhë, zemërçelik.  
 ... N'fushë buçet krisma traktorit,  
 kndon n'fabrikë goja e puntorit,  
 kndon çobani n'mal t'Gramozit,  
 10     n'mal t'Shelzenit e Taraboshit,  
 i kndojnë t'nipit t'Kastriotit.  
 — Kush luftoj n'shi e n'borë?  
 — Enver Hoxha me puntorë.  
 — Kush i dha popullit liri?  
 15     — Enver Hoxha me Parti.  
 Kush e mbron me zjarr marksizmin,  
 kush e lufton revizionizmin,  
 Hrushov - Titon i bani pshesh,  
 tan' t'palanat jau qiti n'shesh?!

20     — Si rrufe si zurret prej motit,  
 ky, asht nipi i Kastriotit,  
 ka folë dje, na e flet sot,  
 fialën e tij topi s'e lot!

25     Rrnoftë Enveri me Parti,  
 gjithmonë para na ka pri!  
 Rrnoftë Enveri përgjithmonë,  
 i falshim ditë ngajeta jonë!

## REPUBLIKËS

Ah moj lulja e dranafilit  
 si u bane per bukuri,  
 amiqt tanë në buzë t'ku finit  
 po t'shikojnë si hala në sy.  
 5 Anmiqt tanë, o more vlla,  
 po perpiqen pa ja da  
 me punë t'vogla e me fjalë t'mdha,  
 dranafilin me na e tha.  
 Dranafilin s'mujnë me e tha,  
 10 se e ka mjell poplli, or vlla!

## RRNOFSH SA MALET I SHTREJTI ATDHE

Rrnofsh sa malet, i shtrejti atdhe,  
 kurrkun shoqin nuk e ke!  
 N'majet tonia permisi re,  
 ku shqyponja ban fole,  
 5 fluturon ni shqype e lirë;  
 plot me gaz e me dëshirë;  
 përmi shkam e përmi gurë,  
 përmi fusha plot me grunë,  
 se sot je ma e lirë se kurr.  
 Kërkoi fushat mar' e marë  
 përmi male t'popllit shqiptar,  
 ku â stolisë me lapidarë,  
 n'prrojna e n'lugje, n'faqe t'shkamit,  
 10 si u la me gjakin e partizanit.  
 Bane çerdhen n'maje t'ahit,  
 se s'ta prek dora e trathtarit,  
 ka ra Shqipnija n'durë t'shqiptarit.

## ATDHE I SHTREJTË ATDHE I LIRE

Atdhe i shtrenjtë, atdhe i lirë,  
 t'mrojmë si shpirtin, t'duem me dëshirë,  
 si shpirtin tim, si kryet e djalit,  
 e mrojmë atdhenë si t'dy syt e ballit.  
 5 Pa atdhe të lirë dielli s'na rrezon,  
 as mi malet tonë shqypja s'fluturon,  
 as shpirtin, as djalin atherë s'ke se ç'e don!  
 Ma i miri asht nji atdhe n'liri,  
 se sa nji pallat i mushun plot me flori.  
 10 Se pallati do t'shemet, florini mbarohet,  
 atdheu jonë i lirë, ai, kurr nuk ao t'rrxohet!  
 Nuk ka gja në botë ma t'mirë,  
 se kur njeriu jeton n'atdhe të lirë.

## NË QOSHE TË PUKËS N'ATE QERRET

Në qoshe të Pukës, n'ate Qerret,  
 Mehmet Shehi trim me fletë,  
 lumti goja mirë po flet:  
 — Le të nigioj gjith bota sot,  
 5 s'asht Shqipnia tokë pa zot,  
 kualët qorra me e kullotë;  
 po shumë të fortë kemi Ushtrinë,  
 pararoje kemi Partinë,  
 kush të kërkoj me mësy Shqipninë,  
 10 ka me pa në ledinë mushkninë.  
 Qeshtu foli Mehmet Shehi,  
 të nigioj Tita e Kenedi;  
 të nigioj Pavli e Kardeli,  
 kush të kërkojn' me msy Shqipninë,  
 15 le t'i marri drrasat me veti;  
 merri drrasat lum tradhtari,  
 se jemi zot i këti vatani.

- Edhe vorrin ta bajmë gati,  
 me nji ushtri si e ka Shqipnia,  
 s'e ka Serbi, as Turcija,  
 s'e ka Greki, as Italia,  
 s'e ka Franca, as Anglia,  
 S'jem' ushtrija e kapitalit,  
 por jem' mbrojtja e vatanit.  
 20 Jem' ushtri popullore,  
 si na i mbrojm' gjith kto fitore,  
 s'shkelim gjakin e dëshmorve.  
 Ç'tha luftari në buzë të kufinit,  
 karshi klikës të trockizmit?  
 25 — Pasha dy dritat e synit,  
 pasha iden'e famshme të Leninit,  
 pasha lulen e drandafilit,  
 pasha kangën e bylbylit,  
 pasha rrezet e forta të diellit,  
 30 s'shkel kurr këtu kamba e armikit,  
 pa shkue gjaku deri në buzë Drinit,  
 për pa u la me gjak Valbona,  
 s'shkel anmiki malet tonë,  
 kjo Shqipni e jonë sa deti,  
 40 s'ka çka i ban krajli, as mreti,  
 nandqind miljon i kem me vedi.

30

### TRIMNESHË ME FLETË GJITHMON U TREGOVE

Shqipni, Shqipni, oj trimneshë më famë,  
 e shkret, e mjer, ti gjithmonë je kanë,  
 je kanë e pa babë, je kanë e pa nanë,  
 ke vuejt në mjegull, ke vuejt në tufanë;  
 qindrove pa pi, qindrove pa ngranë,  
 5 ti, ke ndejtë dathë, e kë ndejtë deshë; ;  
 e buzët tonë kurr s'patën keshë;  
 ty t'rраhi vala e t'rраhi termeti

ty t'shkeli krajli e të shkeli mbreti,  
mbretën e krajla vijshin palë-palë,  
me t'vra e me t'pre, me t'varë në litar.  
Por, trimneshë me fletë, gjithmonë u tregove,  
gjuhën e kombin kurr s'e harrove;  
anmiqve e tradhtarëve kurr s'ju nënshtrove,  
flamurin me shqipe kurkuj s'ja dorzove!  
Shqipni të vajtova, por tash s'kam ma nevojë  
në kangë e në valle gjithmonë po t'këndojoj.

## 31

## NJIZET VJETORI I USHTRISE

... Në Vithkuq të Korçës plakë, (1)  
filluen malet të dhezen flakë.  
E fuqishme zbret ushtria nga këto male,  
ushtri nationale, ushtri çlirimtare,  
ushtri partizane, ushtri vullnetare,  
anmiqtë tradhtar tan i qiti fare,  
të lira u banë tokat shqiptare...

\* \* \*

... Kujtojmë çetat partizane,  
si luftojshin nepër male,  
me 'i mauzere e me 'i taljane.  
Por tash kemi ushtri me famë,  
e armatosun deri n'dhamë...

\* \* \*

... Graniti janë ba kufijt' e Shqipnisë,  
se i ruejn e i mbrojnë të bijt e Partisë,  
ushtari i popullit përgjon në kufi,  
pushkën n'dor dylbitë në sy,  
nuk ndie lodhje, po ban' un'i lumi,  
gishtin n'kamëz synin te thumbi.  
Parti e dashtun, oj nan' e parë,  
burra e gra sot na ke ushtar!...

---

1) Është fjala për formimin e brigadës së parë sulmuese.

## RAM SADRIA

Raka djelli e ka marrë dhenë,  
 djelli i prillit nuk na nxen,  
 ra fashizmi, mur atdhenë.  
 Kur ka hy ky fashizmi i zi,  
 5 terri mbloj t'shkretën Shqipni,  
 n'kamë janë çue gra e fmi,  
 burra pleq, t'reja e t'ri,  
 kanë rrokë armët, n'mal kanë hi,  
 luftë po bajnë për liri.  
 10 N'katër qoshet kah Shqipnia,  
 luftojnë pleqtë, luftojnë rinia,  
 me ta ish dhe Ram Sadria.  
 Ram Sadria prej Dragobisë,  
 15 n'moshë t'vogël kenka nisë,  
 nepër çetat e Malsisë,  
 për çirimin e Shqipnisë.  
 Pak pranvera kanë kalue  
 dhe Shqipnia u çirue.  
 Ram Sadria n'kamë â çue,  
 20 nji letër t'bardhë e ka shkrue,  
 në shpi babës ja ka çue:  
 — Thuej nanës mos kaj për mue,  
 sa t'kem ymër për me rrnue,  
 n'ushtri t'popllit due me qindrue,  
 25 për me mrojtë çka kem fitue;  
 oficer kenka gradue,  
 oficer i biri i t'mirit,  
 ish n'armën e sigurimit,  
 komandant i postkufinit.  
 30 Në detvrë kish pasë qillue,  
 dymbëdhetë ora kur a shkue,  
 vesh e mathë kenka shtërngue.  
 N'vi t'kufinit kur ka shkue,  
 n'kriminela â takue.

- 35 Ram Sadria ish kanë djalë:  
— O ku je, more trathtar,  
sall 'i pllame s'ta lishoj vatanë,  
nuk ta lishoj atdheun aspak,  
për pa e la vendin me gjak!
- 40 Tre sahat paska liftue,  
medet, Rama, â plague!  
Kur ka ba drita me dalë,  
paska folë nja dy-tri fjalë:  
— O, ku jini vllazën shqiptarë,
- 45 ku jini trima kufitarë,  
sot po don shpirti me m'dalë,  
amanet ja u la vatanë!
- 50 N'Dragobi lajmi ka shkue,  
â dekë Rama u kanë kallxue...  
Nana e Ramës duel n'shkallë,  
me lotë për faqe fol ni fjalë:  
— Partisë djalin ja kam falë,
- 55 s'asht i emi, sall Ram Sadria,  
djemt e mi janë gjithë ushtria! —  
Sadri Isufi n'kamë â çue,  
n'Qafë t'Çeremit kur â shkue,  
n'ni shok t'Ramës â takue,
- 60 â takue në nji gradar,  
kapiten i klasit par;  
ja ka folë nja dy-tri fjalë:  
— Rama i dekun e s'asht i gjallë  
unë Partisë ja kam falë;  
mbasi dha jetën për atdhe,
- 65 sot s'ka dekë, po për mu ka le! —  
Kshtu n'ku fi na foli plaki  
për ket gja s'më xen maraki,  
për atdhe s'më duhet djali.  
Tan malsia n'kamë â çue,
- 70 tek dëshmorët janë bashkue,  
Ram Sadrinë për me varrue,  
mbi vorr t'ti janë kanë betue:  
— S'kemi gjakin me ta harrue,
- kem' anmiqt për me i luftue.

## KANGA E PESE USHTARVE

- Lum po ban populli shqiptar  
 si i kena djemt' ushtarë,  
 kryejnë sherbimin pa nji fjalë,  
 pér vatan e atëdhe,  
 5 jadin jetën si me le.  
 Nji oficeri me katër ushtarë  
 prej Komandës lajmi i ka ardhë:  
 — N'maje t'bjeshkës pér me dalë,  
 kta trathëtarët pér me i ndalë.  
 10 Janë ba gadi pér'i dakikë,  
 marrë kanë pushkë, automatikë,  
 njishkollonë atje me hypë.  
 Kur janë nisë djelmoçat e ri,  
 ka njizet vjet nuk kanë përmi,  
 15 oficeri njizet e tri,  
 para ushtarve po m'u pri.  
 Nantogeri, nji zog sokolit,  
 trim prej Laçit të Milotit,  
 para u prin ushtarve t'popullit,  
 20 me dalë n'Qafën e Dobordolit,  
 pér me i kapë trathëtarët e popullit,  
 po ish vështirë nata e dhetorit.  
 N'maje t'bjeshkës kur kanë hi,  
 rajke borë e rajke shi,  
 25 kan qillue jabanxhi,  
 rrugen mirë, medet, s'e dinë!  
 Kur kanë shkue n'maje t'Tringëllimës  
 gjimon maja e Gjyrovicës,  
 vjen tufan prej Kusheticës.  
 30 Prej Shkelzeni vjen furtuna,  
 seç i mbyti kta pesë burra.  
 Mallkue kjosh, moj bieshkë e bardhë,  
 si i mbyte kta ushtarë!  
 35 Ty vullkani të rrënoftë,  
 dielli e hana mos t'rrezoftë,  
 zogi n'ty kurr mos këndoftë,

lulja e verës mós luloftë,  
lisi n'ty kurr mos dushkoftë,  
kingj' as delja mos blegroftë!  
40 Ramazani kah Tirana,  
fort qindrojti kah tufana,  
prit, or trim, se t'kérkon nana,  
me ju këthve si sokol,  
tash po i shkon në arkivol!  
45 Ti moi nana e Ilmisë,  
prej qytetit t'Peshkopisë,  
po t'përbej n'ide t'Partisë,  
hiqu vajit e hiqu zisë,  
vaji s'i ka hije ushtrisë!  
50 Ah, moj nana e Isuf ushtarit,  
prej qytetit të Elbasanit,  
po t'përbej në shpirt të djalit,  
mos t'lotojnë ty syt e ballit,  
vaj s'i ka hie ushtarit!...  
55 I fjalë i thom gjithë Republikës,  
heroik populli i Malsisë  
sa i lajmroi reparti i ushtrisë,  
kanë marë armët e janë nisë.  
Kur po shkojnë malsort e letë,  
60 trup e terthuar bjeshkes përpjetë,  
thue u kanë vu kamve fletë,  
me gjetë ushtarët se ku kanë metë.  
Shpejt i gjeten kta sokola,  
n'ato bjeshkë ku i kish mytë bora,  
65 Ishue s'i kishin armët ka dora,  
shpejt i ulen kah Tropoja.  
Mbyllë i kanë në arkivola,  
para shkolle i kanë rrjeshtue,  
me kunora i kanë lulëzue,  
70 tanë me lot i kanë lotue.  
Kudo n'rrugë e për sokaqe,  
kaishe populli me lot për faqe,  
lotët u shkojshin parë-parë,  
për të dashtunit vllazen ushtarë.  
75 Voitë ka lajmi n'kryeqytet,  
nisë ja ka radia e po flet,

për kta trima që kanë metë,  
 për ushtarët e Shqipnisë  
 si dhanë jetën n'bjeshtë t'Malsisë,  
 n'vend me çue fjalën e Partisë!

### **NUK A KOHA T'RRIMË DUER KRYQ**

Po ju them, o shok' e miqë,  
 nuk a koha t'rrimë duer kryq,  
 jem' t'rrethuem me anmiqë,  
 duhet ta zhdukim demelizmin,  
 ta luftojmë revizionizmin,  
 ta ndërtojmë socializmin;  
 i gjithë poplli i Shqipnisë,  
 njekim rrugën e Partisë,  
 e t'ja plasim zemrën Nikits, (1)  
 5 si e bani veten me pikë,  
 mori t'harmin n'Amerikë.  
 Me ket t'tharm të trahjisë  
 don me ja lshue edhe Shqipnisë,  
 po e goditi grushti Partisë,  
 10 me Enver Hoxhën sekretar,  
 si sod e njeh gjithë bota marë.  
 Partija jonë si mur graniti,  
 sikur valt e Adriatikut,  
 kurr s'ja dha doren anmikit;  
 15 ban Shqipninë kantier ndërtimit,  
 e ka ba si lulja prillit,  
 bash si gurin e xhevahirit,  
 mren binarve të marksizmit,  
 flamurtarja e socializmit.

1) N. Hrushovit

## GJITHMONË ANMIKIT KTHEJA PUSHKËN

Plot, tradhtarë, kupa asht mushë,  
shikoe dreqin, duel në fushë  
dalë na e ka Tita me gushë,  
gjithmonë anmikit ktheja pushkën.  
5 Ik, o Titë, po na e ngjet gushën,  
o ti Titë, he, humt-e vula!  
Ti, ban ish, pér pa pasë pula,  
e je ba sikur kodosh,  
s'prâ, veç ish sikur balosh.  
10 Ti han qullin e Amerikës,  
mban kujdesin e Shqipnisë.  
Ne shqiptart, kan nuk cenojmë,  
me na prek kushi, nuk durojmë,  
i madh e i vogël, grue e burrë,  
15 jem si shqypja permi gurë;  
po i afrove shypes, gishtin,  
të ngul thojt e ta nxjerr shpirtin,  
tane anmiqve jua dredhim shpaten,  
per gjithmonë jau kputim qafen.

## SHNUMISTËT E FSHATIT TONË

Shnumistët e fshatit tonë  
n'hie t'pemës kur pushojnë,  
mitrolozin mirë p'e msojnë,  
shoqi shoqit ja shpjegojnë.  
5 — N'ras se anmiki na sulmon,  
t'jemi gati ta qillojmë!  
Atdhenë tonë na do ta mrojmë,  
me e shkelë kush nuk e lejojmë! —  
Thotë fshatari: — Lum e lum,  
10 antar jam une në SH.N.U.M,

15

kur baj qitje, qes me thum; (1)  
 qes me thum, se jam i ri,  
 t'tana hert n'tzesë i shti; (2)  
 syni jem shum' n'terezi,  
 s'ka çka lyp anmiki n'Shqipni! —

37

### MATRAPAZI DHE KULAKI

I thotë kulaki matrapazit:  
 — Hajde të kjajmë nji farë hallit,  
 se ungjë na u ka zhaba e barkit,  
 barki nisi me u voglue  
 5 tremdhetë vjet si kanë kalue,  
 si Shqipnia asht çlirue,  
 dallaverja ma s'po lue,  
 s'po mujm' popullin me e mashtrue,  
 se Partia e ka skjarue;  
 10 kuku për ty e medet për mue,  
 na kshtu s'mujmë për me jetue,  
 nji plan tjetër për me hartue,  
 diversantave ne me u shkrue...  
 — Mos derzi, ashtu qysh thue?  
 15 Se jam plak e jam qorrue,  
 nuk shoh natën me udhëtue.  
 Diversantave na me u shkrue,  
 në kufi për me kalue,  
 boma e armë kha me na prue.  
 20 Me ecë ditën e me ecë natën,  
 na gje e zeza si Hamit Matjanin  
 Ish Hamiti njeri me pikë,  
 ba ka kurs në Amerikë;  
 paska hipë në parashytë,  
 25 u tha shokve mos me u tutë,  
 mos u tutni e bani gajret,  
 n'parashytë kenka lezet,  
 po s'po dimë ku po na qet?!

1) Qëlloj drejtë

2) I shtie predhat brënda rrëthit të zi.

Zenel Shehi të madhe briti:  
— O Hamit, na zu rreziki,  
parashyta ne na fiki  
tash na kapi sigurimi,  
pa ra mirë në tokë të zotit,  
tash na dënon drejtësia e popullit  
pa pikë mëshirë pa fien e zorit.  
Qaj Hamiti në kamë asht çue,  
çekulinin e ka kërkue  
me Trumanin me bisedue,  
diversantat me i lajmrue:  
— Mos vinë ktej, me u gabue,  
se i gja e zeza si gjet mue.

38

### QESIN GURIN E FSHEHIN DOREN

Amerikës ja lshofsha morden  
si e ngatrrojti te gjithë boten,  
e qet gurin e e fsheh doren;  
nuk lanë ven për pa i fut hunt;  
per ket gja nuk kam marak,  
se ku i kanë shti, kanë dalë me gjak.  
Xhon Kenedi i Amerikës,  
bashkë me Pavlin e Greqisë  
e me Titon e Jugosllavisë  
nji plan t'pafryt e patën nisë:  
«në tri pjesë me e nda Shqiponinë.»  
Kanë ba planin pa hanxhinë!  
Gjenerali i flotës s'detit, <sup>(1)</sup>  
me krvetarin e komitetit,  
u koftë haram buka e shtetit,  
trathti t'madhe i banë mitletit,  
s'i banë popllit, po i kanë ba vetit.

---

1) Ban aluzion te Teme Sejko.

Vinë dallaret e Kenedit,  
minat me ja vu pushtetit;  
por pushtetit t'vegjelisë,  
s'i bajnë gja dinart e Tits,  
as dallart e Amerikës,  
se udhëheq dora e Partisë.  
Avdyl Resuli <sup>(1)</sup> i pip kamishit,  
ish tradhtar i tridhetedyshit;  
vesh e muer gjith Evropa,  
ni xhys leki ja bani koka.  
Teme Sejka n'hie t'ftonit,  
po i bje ziles s'telefonit,  
«t'falë me shnet po i ban Koçit: <sup>(2)</sup>  
— Kam njekë rrugen e Panajotit, <sup>(3)</sup>  
me ja shkelë gjakin dishmorit  
edhe shkollat me ja prishë malsorit,  
me ja marrë fabrikat puntorit.  
Por ky popull në Shqipni,  
nji dhuratë ma shtini n'gji,  
n' «kamp t'pushimit» m'çoi te ti,  
n' «kamp t'pushimit» me t'vertetë,  
ku atje pushoj pér jetë.  
Flet rapsodi n'hie t'blinit,  
nji fjalë ja thotë gjithë imperializmit:  
— S'jem Shqipnia e shtatë prillit,  
s'jem' të Zogit, as të fashizmit,  
s'jem' milicat e Musoliniit,  
të dollarit e të sterlinit,  
po jetojmë n'brigje t'Adriatikit,  
mbroje e kampit t'socjalizmit.  
Kush t'guxoj me na prekë kufinin,  
me duert tona ja nxjerrim shpirtin.  
Rrnoftë Partija sa malet me borë,  
me Komitetin e saj Qendor  
e me n'krye shokun tonë,  
Enver Hoxhën zemerluanin,

2) Pjestar i grupit të Teme Sejkos.

1) Koçi Xoxe

2) Panajot Plaku.

qe 'izet vjet luen timonin,  
sallde nji herë s'e len binarin,  
mren binarve te marksizmit,  
ja thejmë hunt imperjalizmit.

### AMERIKË ME INGLITERË

Amerikë me Ingliterë  
mbet si huti në jezerë,  
puna e tyne e pavlerë,  
marrin Titon për bedel,  
5 për me e çue në Kongobel. (1)  
Kam pa Titon si â ma mirë,  
me nji ngjyrë e me dy ftyrë,  
dje «ka kanë me socjalizmin,»  
edhe sot me imperializmin.  
10 Ka pasë thanë nji fjalë plaki:  
— Burri s'lidhet kurr për laki,  
e lidhë fjala e jo litari.  
Po shkon Titua prej Jugosllavisë,  
larg prej popujve të Azisë,  
15 me u kallxue punën e trathisë.  
Amerika, si kurkush,  
hipë në kumull, e kërkon rrush!  
Ajzenhaueri çka po flet?  
Me englez po merret vesh,  
20 bashkë me ta me ba nji vepër:  
Me i ngjité dhamët ujkit t'vjetër,  
ujkit vjetër me i 'nue dhamë  
e me e lshuë mi Ballkan.  
Kush t'guxojë me e prek shqiptarin,  
25 t'shkojnë e t'pvetin italjanin,  
si ja muer dreqi jorganin.

1) Kongua belge. Rapsodi aludon për udhëtimin famkeq që bëri J. B. Tito në Afrikë, Azi, me misjon për të penguar hovin revolucionar të lëvizjes N. Clirimtare në këto vende.

Kush t'guxojë t'prek' t'madhen Kinë  
t'shkojë e t'pveti Xhaponinë.

30

Flet shqiptari trim besnik,  
lumte na për Kinën mik,  
si me vepra mron socjalizmin,  
tuj luftue imperjalizmin  
demaskon revizjonizmin  
e përpara çon njerzimin.

40

### PAQE TË KËRKOJMË DRITN' E BUKUR TË TOKËS

Kushtrimi i madh si ka lshue populli shqiptar,  
sot i bajmë thirrje të gjithë botës marë,  
t'zive e t'bardhve vllazn e proletarë,  
të ngrihemë me zanë tonë të fortë,  
paqen ta kërkojmë, si gjanë ma t'shtrejtë në  
5 botë!

5

Paqa asht për ne dhe ata do t'a fitojmë,  
lmoshë nga imperialistat kurr ne nuk kërkojmë!  
Trathtart e Londrés, t'Amerikës apo t'Bonit,  
paqen kërcnojnë me bumet e automit.

10

Shikoni gjakpirsa, veniani gishtin kokës,  
se paqen e mrojnë sot gjithë popujt e botës;  
puntori do paqe dhe z'di se shka asht friga,  
aj s'lejon flagë t'i digjet fabrika!

15

Ujku, nu' do paqe, se aj bahet më dysh,  
goja i jet thatë, dhe barku pa mish.  
Nanat e gjithë botës ngrihen si vetima,  
paqen kërkojnë, fmi mos ketë jetima.

20

Neve jem' luftarë, natyra na fali,  
edhe luftës kurr s'i tutet shqiptari!  
Neve mbrojmë paqen se kshtu na e mson Partija,  
se të gjitha t'drejtat sot i gzon Shqipnija.  
Ngrehniu pra, t'gjithë popujt e botës,  
paqen t'kërkojmë, dritn' e bukur t'tokës!

50

## ÇIKA E PLAKA Ç'KA KANË THANË

Çika e plaka çka kanë thanë:  
 — Rrnoftë Partija, e jona nanë,  
 qi e skjaroi popllin t'tanë!

Formoi çeta partizane,  
 5 në qytete dhe në male;  
 zhduku Italjen e Gjerman,  
 klyshët e tyne kah janë kanë,  
 lirinë poplli e ka marrë,  
 të drejta grues i ka dhanë,  
 10 ku t'doj burrin për me marrë.  
 T'marri burrin ku t'doj vetë,  
 n'daq katund, n'daq qytet,  
 me çue jetën me lezet. —  
 U çue plaka nji fjalë pe e flet,  
 15 ban për veti: «Haj medet!»  
 ... Mjera unë kur jam fijue,  
 Zogi mret ka pa' qillue;  
 atherë kur qe Zogi mret,  
 mue m'dha baba e nana e shkretë;  
 20 shumë kanë marrë pare, ryshfet,  
 napulona shtatë e tetë,  
 dhen e dhi der m'pesmëdhetë;  
 mue hiç nuk më kanë pvetë;  
 burri em, plak i keq,  
 25 plak qyqari ka qillue,  
 ditë e natë më ka ngujue,  
 s'muj me thanë se nuk e due,  
 se kanë me m'gri me m'coptue;  
 kan' me m'ba copa e grima.  
 30 Rrnoft Partia, nana e jonë,  
 qi e zhduki ket zakon!

## JA KU PO VINË T'RIT E MALSISE

Ndigjoni ça ka ndodhë sivjet,  
 nuk ka qenë qe dymi vjet:  
 — Gjithë fshatrat janë mbledh n'qytet! (1)  
 Kqyri, kqyri shkojnë me radhë,  
 5 kur po vinë tanë parë-parë,  
 sikur lumi vjen me valë,  
 instrumentistë e kangatarë,  
 fyellaxhi edhe kcimtarë.  
 Ja, ku po vinë t'rit' e Malsisë,  
 10 si vetima si i bjen pyllsë,  
 pej Shkelzeni (2), n'rranza t'Grisë, (3)  
 vin pej Tplani (4), pej Dragobisë, (5)  
 mirë po i bien çitelisë!  
 Na vinë çikat me pshtjellakë t'gjanë,  
 15 kcim t'bukur po na bajnë,  
 kur na dalin para tupanit,  
 bash, po, si plumat e paqit. —

## DIMNI

Po vjen dimni në dhетор  
 vjen me shi, e vjen me borë,  
 çonu, çonu, o malsorë,  
 ju malsorë si rrini n'malsi  
 5 dushk e dru çoni në shpi,  
 dhe silazhin per bakti,  
 se vjen dimni, koft'i zi,  
 vjen me bor' e vjen me shi.  
 Kshtu vjen dimni kasap me thika,

1) Bëhet fjalë për festivalin folkloristik të rrëthit B. Curri më 1959.

2, 3, 4, 5) zona të rrëthit B. Curri.

10 çka â mi tokë i dahet rrita,  
 ngatet nata e shkurtohet dita  
 e bjen borë der n'gjysë tê ahit,  
 bertet lopa pej n'derë t'ahrit,  
 po i ba za kti kryetarit:  
 15 — S'e ka mushë kulln e silazhit,  
 me m'ushqye tê tan dimnin,  
 në prenverë t'kesh kthye shpërbëlimin,  
 t'mushi shekën e ta maj viçin!  
 Po bisedon lopa me dhi:  
 20 — N'qafë na pastë kjo kryesi,  
 dushk as sanë nuk na kanë shti,  
 rodi i mishit s'ka metë në bri,  
 duket mushknija si n'radoskopi,  
 katerdhëtë ditë t'arbainit  
 25 qindron plaki n'buzë tê hinit,  
 arbaini kaloi derën,  
 plaki zu dredhi musteqen,  
 i thotë dimnit: — Ma more t'keqen!  
 se edhe i herë po e gzojmë pranverën;  
 30 del pranvera në behar,  
 mushet mali dushk e bar,  
 dirgjet bujki e puno' n'arë,  
 shkon bujkesha e i qet farë,  
 atherë dardha lulon,  
 35 bylbyli kënon,  
 qingji ladron,  
 delmja blegron.

44

### BORË KA RA A BA KJAMET

Gazer coj haki siviet. (1)  
 borë ka ra, â ba kiamet;  
 me i pasë plaki niqin vjet,

---

1) Këtë këngë rapsodi e ka ngritur për dëborën që ra në dimnin e vitit 1954-55.

s'e ma men tanë ket gazep.  
5 S'e ma men plaki, as baxhia,  
s'e përmen as historia,  
ka ra bora, a mlue shpia,  
britshin edhe e britke dhia,  
fort ka vujtë nuse e baxhia,  
10 na i mloi bora kroje e via,  
kem' çkri borë nëpër kusia,  
me pi gjaja dhe robnia.  
Fort kanë vujtë çobanija!  
Fort kanë vujtë çobat e zi,  
15 kuj i qilloi tuba me dhi,  
tre muj dit n'mal s'i ka shëti;  
për tre muj n'mal s'i ka lshue,  
s'e di dushkin <sup>(1)</sup> ku ja ka 'nue,  
pa e pasë busllën me u orientue,  
20 se të tana otergjet na i kanë rraxue.  
Borë ka ra për me u merue,  
nanë javë ditë për pa pushue,  
nanë herë shpijat i kem' çplue. <sup>(2)</sup>  
Shpeshherë rasti ka takue,  
25 te mullini s'un jem' shkue,  
tri dit bukë s'kena kerkue <sup>(3)</sup>,  
n'kokrra drithi kem' jetue.  
N'gjys të lisit bora ka shkue;  
rreth i Currit, rreth malor,  
30 ranë sivjet nizet pllame borë.  
Shpejt pushteti popullor,  
me ballon na furnizon.  
Rrnoftë piloti i Shqipnisë,  
me udhzime t'mira t'Partisë,  
35 ndihmë i çoka fshatarsisë.  
Kur ka ra n'luk të Malsisë  
vu ja ka synin turbisë,  
e gjet grykën e Dragobisë,

---

1) Mullarët me gjethë dushku.

2) Zbuluar.

3) ve në gojë, shijoj; këtu ngrënë.

ushqim t'mirë i soll robnisë, (1)  
 40 krune t'gryjta i soll bagtisë.  
 Vjen balloni rreth kufinit,  
 ja gzo' zemrën gjithë njerzimit,  
 aeroplani përmi borë,  
 parashutat kur po i lshon,  
 45 katunart te tanë po i gzon.  
 Parashuta mjedis oborrit,  
 ja gzozi zemrën gjithë puntorit!  
 T'kish ra borë qeshtu n'koh t'Zogit,  
 kish marue gjysa e popllit.  
 50 Kur â kanë Zogi n'Tiranë,  
 me sy s'pamë maqina as ballonë.  
 Aeroplani bardh si bora,  
 kaloi male, kaloi kodra,  
 rrnoftë Partia Enver Hoxha,  
 55 po e hjek t'keen si me e hjekë dora,  
 i shpëtoi gjithë zonat tonë.

## 45

### PËRSHËNDETJE PIONIERËVE

Mirsevini, t'dashtun fëmij,  
 t'veshë, t'mathë për bukuri,  
 shif si u rrit nana Parti,  
 ju ma gzofshi Vitin e Ri!  
 5 Ju po rriti si lula n'mollë,  
 notën dhetë (2) merrni në shkollë.  
 Në Shqipninë tonë sot ka dalë vera,  
 do dilni doktorë, teknik, inxhiniera,  
 msues t'mirë, trima oficera.  
 10 Mirrni përshëndetjet e mia pra, o fmi,  
 e ma gzofshi Vitin e Ri.  
 me popullin shqiptar e nanën Parti!

1) Për t'u ardhë në ndihmë zonave të izoluara nga dëbora me vendim të qeverisë u dërguan me aeroplan ndihma, si ushqime, medikamente etj.

2) Notën më të mirë

~~+~~ LENIN IT

Me njizet e dy të prillit  
 u plotsuen nandhetë vjet,  
 si leu shpresa e njerzimit,  
 leu njeriu i vërtetë.  
 5 Leu Lenini, shpresë e gjallë,  
 per punitore e katunare,  
 paska lindë si yll sabahit  
 baba i gjithë proletariatit.  
 Kshtu malsori po ju flet:  
 10 — Jam shqiptar analafabet,  
 S'e di mirë fjala ku m'vret,  
 për nji gja shpirti më heq:  
 — Me Leninin me u marrë vesh,  
 me i kallxue xha Leninit,  
 15 për sukseset e socjalizmit,  
 për disfatën e imperjalizmit,  
 pata Leninit me i diftue  
 rrugën tande e kem' vazhdue...  
 O Lenin, o i vërtetë,  
 20 ti je i gjallë e nuk ke dekë,  
 për ty flet sot bota marë,  
 të ka n'zemër çdo shqiptar,  
 sikur valt si i ka Valbona,  
 gjithmonë rri ne zemrat tona!

DYZETVJETORI I USHTRISË SOVJETIKE

T'ishna pllum me fluturue,  
 fluturim në Moskë me shkue,  
 në Kremlin për me pushue,  
 n'ushtrinë sovjete m'u takue,  
 5 fest' e madhe u ka qillue:  
 Dyzet vjet si asht formue.

Kur gjithë bota ish n'errsinë  
sovjetikt kishin Partinë,  
menjihërë ngritën ushtrinë,  
e përmysen borgjezinë,  
fituan dritën e lirinë;  
n'linje t'lartga te Evropës,  
socialist nji e gjashta e botës.  
Disa kohë kishin kalue,  
10 kur Hitleri n'kam a çue  
luftën e dytë e ka fillue,  
tan Evropën ka sultmuae:  
— Shpija djegë, fabrika çkatrrue. —  
Ju rrit menja Hitlerit t'zi  
15 Marrë ka top avjon zingli,  
shumë armata me ushtri,  
sovjetikt i paska msy,  
me jau marrë t'amlen liri,  
Ushtrinë e kuqe për me e gri.  
N'kamë a çue Josif Stalini,  
20 Ushtrisë t'kuqe para i prini,  
e dhezi llullen, dredhi musteqen,  
i thotë Hitlerit: — Ti, na marsh t'keqen!  
po i ke shti brinat në luan,  
ushtart' e kuq para i kam  
25 dhe s'e lshoj pa t'ba tufan. —  
Ushtrija e kuqe ka sultmuae,  
boshti i parë u çkatrrue, <sup>(1)</sup>  
krejt Ballkani u çlirue,  
30 njimdhetë miljon n'Berlin kanë pushue.

---

1) Boshti Romë — Berlin — Tokio

## NJI ASHT KINA DHE SHQIPNIA

Lum e lum për ty Shqipni,  
 kush përpara asht tue pri,  
 Enveri, nana-Parti.  
 Partia jonë zemër luane,  
 5 prinë në mjegull e tufane,  
 timonjere në oqeane.  
 Pse shqiptarët rrinë serbez,  
 s'i trem serb, as malazez,  
 10 s'i trem greki si çerkez,  
 as taljani pupël - këndez,  
 kemi mik popullin kinez.  
 Gjimon deti i Adriatikit,  
 janë vaporret e Çin-Ma-Çinit.  
 Pse ushton porti i Durrsit?  
 15 — Nga vaporat e Mao-Ce-Dunit,  
 që po bjenë tonat e grunit,  
 grunë e miser për Shqipni,  
 bjen traktora për bujqësi.  
 Mao-Ce-Duni tha nji fjalë:  
 20 Kush e prekë popullin shqiptarë,  
 ka me e djegë flak' e barutit,  
 kanë me korrë breshnitë e plumbit,  
 se ka prek Kinën e Mao-Ce-Dunit!  
 Plastë tradhtari, plastë anmiki,  
 25 si kujtoj Shqipninë e fiki,  
 me bllokadë ekonomike,  
 me shantazhe, presione frike.  
 Por s'frigohet jo, Shqipnia,  
 se në ballë na prinë Partia,  
 30 udhëheqë popullin përdore,  
 për çdo ditë korren fitore,  
 për çdo ditë nji knetë u tha,  
 për çdo ditë nji shkollë u ba,  
 për çdo javë nji kombinat,

35 për çdo orë nga nji pallat!  
 O Enver, sokol me fletë,  
 o marksisti i vërtetë,  
 i pavdekshëm ke me mbetë,  
 me Shqipnin zemërçelik,  
 40 e me Kinën e madhe mik,  
 që na prune kaq lavdi,  
 e lulzove këtë Shqipni!  
 O Parti, o nana jonë,  
 ty të paçim përgjithmonë!  
 45 ti na prin e na mëson,  
 ti na rrit, na edukon,  
 nga rreziqet na shpëton,  
 në dorë të Trockizmit s'na lëshon.  
 Ty Parti, zemrën ta falim,  
 50 të falim jetën, të falim djalin,  
 të falim djersën, të falim gjakin,  
 por të gjallë s'e lëshojmë prakin!  
 Ne të parët na kanë thanë:  
 Këtu hasmin mos me e lanë,  
 55 marre e turp ne mos me hiekë,  
 për atdhe të tanë me vdekë!  
 Në kto troje ane mbanë,  
 na drejton Partia nanë,  
 pararoja në Tiranë,  
 60 Kina «e vogël» miku jonë,  
 nuk asht shumë, shtatqin milionë,  
 le të rrojë për jetë miqsiat  
 nji asht Kina dhe Shqipnia!

### VIZITA E DELEGACIONIT KINEZ NË SHQIPËNI

Pvetin krajlat e mbretetria,  
 pvet Afrika e Azia,  
 Amerik', Australia:

- Zo' ku janë Çu En; Çen Jia? (1)  
 5      — N'atdhe t'lirë kah Shqipnia.  
 Ka ra dielli i vertetë,  
 po zdrit tokë e po zdrit det,  
 nji mik të ri Shqipnia pret,  
 mik i mir' e dajamane,  
 10      burr i shtetit Kinës Madhe.  
 Do t'i bajmë muhabet,  
 siç e kanë shqiptart adet:  
 do ja shtrojmë sofrën bujare,  
 buk' e kryp' e zemër shqiptare.  
 15      Shqipnia jonë nji vend me famë,  
 sot bajnë valle e sot bajnë kangë.  
 Kta trockistat kanë marrë nam,  
 atje ka vaj edhe gjam,  
 u rresht toka nën kamë;  
 20      nën kamë toka po u rrshet,  
 kshtu u tha shoku Mehmet.  
 — O trockista, kofshi mallkue,  
 me imperializmin ini bashkue,  
 kini dalë Kinën me frenue,  
 25      atomin me ja ndalue.  
 Po s'ndalet zogu pa fluturue,  
 po s'ndalet lumi pa udhëtue,  
 s'ndalet dielli pa rrezue,  
 s'ndalet toka pa u rrutullue,  
 s'ndalet Kina pa marshue.  
 30      Çu En Lai a çue n'kamë,  
 don me hipë në aeroplan.  
 — Lamtumirë, na ka thanë.  
 Tanë Shqipnia a çue në kamë.  
 35      — Udha e marë, tek i kanë thanë.  
 Mik me Kinën jem për jetë,  
 n'rrugë t'marksizmit të vërtetë.

1) Çu En Lai, kryetar i Kshillit të Shtetit të Kinës dhe Çen Ji, ministër i jashtëm, që vizituan vendin tonë në ditët e para të janarit 1964.

## BURIMET E LËNDËS

- I Kënga nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8, 12, 16, 17, 18, 19, 20, 24, 27, 28, 34, 35, 36, 37, 38, 40, 41, 42, 44, 46, 47, (mbledhur nga Qemal Haxhihasani).
- II Kënga nr. 13, 25, 32, 39, 43, 45, 48 (mbledhur nga Arsen Mustaqi).
- III Kënga nr. 7, 10, 11, 26, 33 (mbledhur nga Simon Gjoni).
- IV Kënga nr. 9, 14, 15, 30, 31, 49 (dërguar nga autor).
- V Kënga nr. 21, 22, 23, 29 (marrë nga vëllimi Për Partinë Shqipe mali).

## NJERËZ, NGJARJE, VËNDE

**ABDYL RESULI** — agjent i spionazhit grek, armik i betuar i Republikës popullore të Shqipërisë. pjestar i grupit tradhëtar të Teme Sejkos; dënuar nga Pushteti Popullor.

**BAJRAM CURRI** — hero i popullit, një nga figurat më të mëdha patriotike të maleve tona të Veriut; luftëtar i pamposhur për një Shqipëri të lirë e demokratike; u vra në Dragobi më 29 mars 1925 nga agjentët e Ahmet Zogut.

**BAGAJ** — katund i Malësisë së Gjakovës prej nga është marrë uji i një kanali vaditës, i cili ujit tokat pjellore të Cërrnicës.

**BEK SADIKU**.— Nga Krasniqja, luftëtar dhe trim i rallë, tregoi zotësi të paparë në luftë kundër Maxhar Pashës.

**BINAK ALIA** — udhëheqës i mësorve të Krasniqes në luftë kundër Maxhar Pashës.

**BJESHKA E GURIT** — Bjeshkët e namuna në Alpet e Veriut.

**BTYÇI** — Krahinë në Malësinë e Veriut, në lindje të Qafës së Luzhës në rrithin Bajram Curri.

**BUDO ISUFI** — hero i punës socialiste traktorist që ka punuar për çeljen e tokave të Cërrnicës (shih këtë fjalë).

**CERRNICA** — ish zonë pyjore në rrëthim Bajram Curri, ku pas çlirimt u hapën toka të reja dhe u bë një zonë bujqësore e rëndësishme në rrëthim e Trojës. Këtu janë vendosur shumë familje të shpërngulura nga Malësia e Nikaj — Merturit.

**ÇIN-MA-ÇINI** — Kina, në të folmen popullore.

**ÇUKA E PAQËS** — me këtë emër u pagëzua pas çlirimt Maja e Hekurave, një nga majat më të larta të Alpeve tona të Veriut.

**DEZZDARI** — kodër në katundin Bunjan, ku mbaron Cernica (rrëthi Bajram Curri), përmëndur për luftimet e ashpra kundër ushtrive turke me Maxhar Pashën në krye.

**DRAGOBIA** — luginë në Alpet e Veriut midis maleve Kollata, Malit të Gjarpërit dhe Majës së Hekurave, ku është vendosur katundi Dragobi.

**FANGU** — katund i Krasniqes, në rrëthim Bajram Curri, ku më 17 shkurt 1944, u bënë përpjekje ndërmjet gjermanëve që hynë nga Gjakova për të shtruar Tropojën dhe çetat partizane që vepronin në këto anë.

**FUSHA E TORVIOLLIT** — në katundin Bulqizë rrëthi Peshkopi, e përmëndur për luftimet e zhvilluara Midis turqëve dhe shqiptarëve me në krye Gjergj Kastriotin, Skënderbeun.

**GASHI** — krahinë (fis) në rrëzë të Malit të Shkëlzenit, në pjesën lindore të luginës së Valbonës që përfshin katundet: Kovac, Luzhë, Babinë, Kérnajë, Hasaj etj. në rrëthim Bajram Curri.

**GURI I KUQ** — vënd strategjik në krahinën e Dukagjinit.

**GRIA** — katund i rrëthit Bajram Curri, kufi me Bunjan.

**GRYKA E DRAGOBISË** — luginë midis maleve Shkëlzen dhe Majës së Hekurave, nëpër të cilën rrjedh lumi Valbona, e përmëndur për qëndresën e Bajram Currit me 29 Mars 1925.

**HAMIT MATJANI** — kriminel, agjent i spiunazhit grek i kapur dhe i dënuar nga organet e pushtetit popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë, për krimet e kryera.

**KAMI** — katund në rrëthim Bajram Curri, qendër me rëndësi për rezervat e kromiteve.

**KARDELI (EDUARD)** — teoricien revisionist jugosllav, armik i betuar i vendit tonë, bashkëautor i shumë komploteve të thurura kundra Republikës Popullore të Shqipërisë dhe P.P.SH.

**KONGOBEL (KONGUA BELGE)** — shtet i pavarrur n'Afrikë; ish koloni e Belgjikës që u bë vatër e intrigave dhe komploteve të reaksionit ndërkombëtar kundër popullit kongolez.

**KOLKURTI** — ara dhe livadhe në mbarim të katundit Bunjan në rrëthim Bajram Curri.

**KOLGECAJ** — katundi ku u ngrit qendra administrative e rrëthit Bajram Curri.

**KULLAT E FANGIT** — kulla në lagjen Fang të katundit Bunjan, ku u zhvilluan luftime të përgjakshme midis malsorëve trima dhe hordhive turke me Maxhar Pashën në krye.

**KUSHETICA** — bejshkë në jugë-perëndim të majës së Dobërdolit në Alpet e Veriut.

**KRASNIQJA** — krahinë (fis) në rrithin Bajram Curri, në anën e djathtë të lumit Valbona, në rrëzë të maleve Maja e Hekurave dhe Korja e Merturit që përfshin katundet: Bunjan, Ndojan, Markaj, Geghyzen, Selimaj etj.

**MAJA E GJUROVICËS** — majë mali në Alpet e Veriut.

**MAJA E TRINGELLIMËS** — majë mali në mes të Pojanës e Radeshës në Alpet veri-lindore.

**MARKAJ** — katund në veri të qytetit Bajram Curri, vendlindja e rapsodit *Sokol Arifi*.

**MAXHAR PASHA** — komandant' i ushtrisë turke, që qe dërguar kundër Malësisë së Veriut e cila nuk pranonte t'u nënshtrohej vendimeve të Kongresit të Berlinit; malësorët trima e vranë Maxhar Pashën; i prenë kokën, ia vunë në një hu, dhe me të demonstruan nëpër rrugë, duke shfryrë në këtë mënyrë urejtjen e tyre kundër Turqisë.

**MIC SOKOLI** — nga katundi Bunjan i Krasniqes, një nga udhëheqësit më të shquar të forcave të armatosura të Lidhjes së Prizrenit, që u ndesh me ushtrinë turke në prill të vitit 1881.

**PANAJOT PLAKU** — agjent i regjur i revisionistëve jugosllavë, renegat, armik i betuar i Pushtitet Popullor.

**PAVLI** — mbret i Greqisë, autor i shumë komplloreteve të kurdisura kundër vendit tonë, në bashkëpunim me revisionistët jugosllavë dhe imperialistët Anglo-Amerikanë.

**QAFA E CEREMIT** — qafë në kufi me Jugosllavinë, pranë malit të Kallatës e Majës së Gatë në Alpet verilindore.

**QAFA E DOBËRDOLIT** — qafë në Alpet veri-lindore, që lidh bjeshkën e Dobërdolit e të Sulbicës.

**QAFA E KOBILES** — qafë mali në Alpet e Veriut.

**QAFA E LUZHËS** — qafë në rrugën automobilistike Shkodër-Bajram Curri, që lidh Pacin me Luhën; quhet edhe Qafa e Gashit.

**QAFA E MORINËS** — qafë afër Tropojës, midis Majës së Dhive dhe Shkëlzenit, që lidh Malësinë e Gjakovës me Kosovën.

**QERRETI** — katundi në rrëthim e Pukës.

**RAM SADRIJA** — nga katundi Dragobi, rrëthi Bajram Curri. Efektiv i forcave të mbrojtjes së kufirit, ra heroikisht në kufi në përpjekje me bandat e diversantëve që vini nga Jugosllavia.

**RUSTEM ZEQIRI** — malësor nga Krasniqja, i cili tregoi trimëri të rallë në luftë kundër Maxhar Pashës.

**SADRI ISUFI** — nga katundi Dragobi i rrëthit Tropojë, shok armësh i Bajram Currit; baba i dëshmorit Ram Sadrija.

**SALI MANI** — nga Krasniqja, rrëth i Tropojës; shok armësh dhe bashkëpuntor i Bajram Currit, (i ati i dëshmorit të Luftës Nacional Çlirimtare Jah Salihit).

**SECI** — lagje e katundit Markaj (Bajram Curri).

**SHKAMI DIZDARIT** — buzë lumi Valbona në katundin Bunjan, ku u zhvilluan luftime të ashpëra kundër hordhive të Maxhar Pashës, me malsorët trima të Gashit e të Krasniqes.

**SHKALLA E MAGJYPIT** — shkallë natyrore në katundin Gri rrëthi Bajram Curri.

**SHKËLZEN** — një nga majat më të larta të Alpeve shqiptare në rrëthim Bajram Curri.

**TEME SEJKO** — agjent i spiunazhit grek e jugosllav; i cili më 1960, në bashkëpunim me Flotën e VI-të Amerikane të Mesdheut, organizoi komplott përrëzimin e Pushtetit Popullor, dënuar nga organet e drejtësisë të R. P. të Shqipërisë.

**TPLANI** — Katund në rrëthim Bajram Curri në jug-lindje të tij, në anën e majtë të Lumin Valbona.

**VAJZA E KASTRATIT — (BAJZA)** — katund në rrëthim e Shkodrës.

**ZENEL SADIKU** — agjent i zbulimit grek, kriminel, kapur e dënuar nga organet e Pushtetit Popullor të R. P. të Shqipërisë.

## F J A L O R T H

- aferim *ndf.* (t.) të lumtë.
- adet-i *em.* (t.) zakon.
- arbain-i *em.* 40 ditët më të ftohta të dimrit, palca, nyja e dimrit.
- avlli-a *ef.* oborr, muri që rrëthon një shtëpi a një kopësht.
- bedel-i *em.* (t.) zëvëndës, shërbëtor.
- bojli-a *ef.* qershi.
- bung-u *em.* lloj dushku 12-30 m. i lartë me lëkurë t'errët.
- burxhi-ja — burxhi — *ef.* (t.) zëri i flamurtarit, udhëheqësit; tellalli.
- cung-u (*ose sung-i*); *em.* pjesa e një lisi të prerë që mbetet në dhe.
- çerkez-i *mb.* i keqi; i ligu.
- çipçi-u (*dhe çipçia*) *em.* (t.) bujk; ai që punonte tokën e një pronari.
- dajamane *mb.* (t.) i zgjedhur.
- danam *ft.* (t.) baj danam; bëj festë të madhe, festë publike.
- dangë-a *ef.* njollë, damkë.
- dind (*u*) *fint.*; u ngritën në këmbë përa luftë.
- dugajë-a *ef.* (t.) dyqan.
- exhel-i *em.* (t.) vdekje e paracaktuar nga zoti.
- fukara-ja *ef.* (t.) i varfër, njeri që s'ka asgjë.
- gazep-i *em.* (t.) fatkeqsi, vuajtje.
- goxhuf-i *em.* xhaketë.
- gradar-i *em.* nënoficer, *ose* oficer.
- hajgare *fr.* bëj hajgare; e katandisë tietrin në një gjëndje që të qeshë bota me të, të tallet.
- harasan-i *em.* llac.
- jezer-i *em.* (t.) mjegullë.
- kamish-i *em.* (t.) nië lloj çibuku.
- kanxh-i *em.* këndezi.

krajl-i *em.* (*sll.*) mbret.  
krajli-a *ef.* (*sll.*) mbretëri.  
miledinat *efsh.* meloditë; këtu: *këngët.*  
ngujohem *ft.* mbyllem, rrëthohem.  
ortek-u *em.* avalansh me dëborë.  
ordi-a *ef.* (*t.*) ushtria.  
pojat-a *ef.* kasolle.  
rip-a (*rripë*) *ef.* tokë e përpjetë, vënd i varur, tokë e  
varur, shpat.  
riptë *ndf.* pjerrët, që nuk futet asnjë pikë brënda.  
singi-a *ef.* (*t.*) bajonetë.  
stërvinë-a *ef.* ngordhësirë.  
stom-i *em.* breg, vetull që ndan arat prej njera tjetrës.  
sukë-a *ef.* kodër e ulët, kodrinë.  
shekë-a *ef.* kapuç, ku mbahet bylmeti.  
tagan-i (*jatagan*) *em.* shpatë.  
tupan-i *em.* daulle.  
turbi-ja *ef.* dylbi.  
t'tharm-i *em.* maja, fara, ranxa.  
urdi-a *ef.* ushtri.  
vezulloj *fint.* shndris.  
vnoj *ft.* vendos.  
xhihan-i *em.* (*t.*) populli.  
zingërlı, *me zingërlı* me vrull si shigjetë (duke fluturuar).

## TRYEZA E LËNDËS

Faqe

1) Lufta e Krasniqes kundër Pashë Maxharit .....	7
2) Mic Sokoli n'dy tagana .....	8
3) Bajram Curri n'shpinë t'atkisë .....	10
4) Më shtatë prill kur doli zani .....	11
5) E ç'janë këto pushkë që po kërcasin .....	12
6) Diell i bukur i ra Malsisë .....	12
7) O Parti o nana jonë .....	14
8) Liri e drithë na dha Partia .....	15
9) Lavdi thurri Partisë nanë .....	17
10) Trembëdhjetëvjetori clirimt .....	18
11) Rroftë Partia e Pushteti .....	20
12) Kongresit të katërt të P.P.SH.	21
13) Lum po ban poplli Shqipnisë .....	22
14) Dragobisë .....	23
15) Pesëdhjetë vjetori .....	24
16) Ndërtojmë socializmin, lulëzojmë Shqipërinë .....	25
17) Votimet e 3 Qershorit 1962 .....	26
18) Lum për ty Malsia ime .....	27
19) Ja pra shokë Malsia ime .....	28
20) C'ka Malsia tuj gjimue .....	29
21) Kur tinglloj zani Partisë .....	31
22) Kërcet mina bahet jezer .....	32
23) N'Çukë të Paqes n'Shelzen t'Gashit .....	33
24) Hidrocentrali «Karl Marks» .....	33
25) Enver Hoxha .....	35
26) Republikës .....	36
27) Rrofsh sa malet i shtrenjtë atdhe .....	36
28) Atdhe i shtrenjtë, atdhe i lirë .....	37
29) Në qoshe të Pukës n'atë Qerret .....	37
30) Trimmeshë me fletë gjithmonë u tregove .....	38
31) Njizet vjetori i Ushtrisë .....	39
32) Ram Sadria .....	40
33) Kanga e pesë ushtarve .....	42
34) Nuk a koha t'rimë duer kryq .....	44
35) Gjithmon anmikit ktheja pushkën .....	45
36) Shnumistët e fshatit tonë .....	45
37) Matrapazi dhe kulaku .....	46
38) Qesin gurin e fshehin dorën .....	47

Faqe

39) Amerika me Ingliterë .....	49
40) Paqe të kërkojmë dritn' e bukur të tokës .....	50
41) Çika e plaku ç'ka kanë thanë .....	51
42) Ja ku po vinë t'rit e Malsisë .....	52
43) Dimni .....	52
44) Borë ka ra a ba kjamet .....	53
45) Përshëndetje pionierëve .....	55
46) Leninit .....	56
47) Dyzet vjetori i Ushtrisë Sovjetike .....	56
48) Nji asht Kina dhe Shqipnia .....	58
49) Vizita e Delegacionit Kinez në Shqipëri .....	59
BURIMET E LËNDËS .....	61
NJERÉZ, NGJARJE, VËNDE .....	62
FJALORTHI .....	68